do t' e kishte bêr at' udhë
për me e mbushur qitas rangën
n' atê vênt ngā mê kush vate
nuk këthehet për të rēja!
Po n' rrethim të Shkodrës s' lartë
gjith u duk i pandërruam
gjaku i vjetër edhe i mirë
i Tanush Muzaq Topīs
e i së motres s' Skanderbegut.
Mos gëzohu, o bīr i Shkinës,
çë bên kryq kūr më të zezat
për me vênë jē ndë rrugë;
mos gëzohu ti, i pashpȳrt,
çë vret pleqë e foshnja e grā,
(ashtu Zoti t' vraft me pikën!);
mos gëzohu në prej tēje,
tek e shkreta Fushë e drûvet,

δ 58 bīr‖ bîr KT

ε 33 mâc qui e altrove AB. 45 Sadrazemit A.

benché lasciato vivo per sua vergogna.
In Stambul ancora meglio
lo conobbero il mondo e il Sultano.
Essi constatarono che a lungo non istette
in dolorosa attesa
lo spirito forte di Gani Bey:
perché nel mondo eterno Agì di Faja
a lui fece portare ad ogni costo
i saluti del grande fratello,
degli agricoltori e quelli propri:
li fece portare per il figlio di Sadriazemi,
facendolo partire dal ponte di Galaba.
Costui avendo ucciso (Gani Bey)
era destinato a morire.
E se fosse anche stato di Abdul Hamid
il più caro tra i figlioli,
senza remissione e per forza
avrebbe percorso quella via
e assolto subito il mandato
in quel mondo da dove
chi vi si reca non ritorna più.
Ma nell'assedio di Scutari magnifico,
si rivelò e del tutto immutato
il sangue antico e nobile
di Tanush Musacchio Topia
e della sorella di Skanderbeg.
Non rallegrarti, o figlio della Slava,
che ti fai la Croce quando le nequizie
stai per commettere;
non rallegrarti tu, o crudele,
che uccidi vecchi e bimbi e donne
(così Iddio possa ucciderti con un colpo);
non rallegrarti se per tuo mezzo,
nella desolata pianura delle querce

u plandos Hasan Rizaja,
me pabese i gjuam më t' errët
prapa krahëvet, si di
ti, o firuk! Ato të holla
kot i prishe, se në vênt
t' atîj qifti t' zî t' Bagdatit
të rrî m' ballë zogu i shqipes.
Zogu i shqipes të rrî m' ballë,
ore i nêmur gjon i natës,
për me t' ndukur, për me t' rjepur,
për me t' thyer e krahë e shpinë,
para edhe se t' hîsh në çerdhe,
n' atê çerdhe mbretërōre
çë me bîndë për së largut
pā Sultan Mehmeti i dŷt,
e te ku për fat të mirë
ti do t' gjēsh të keqen tênde!
Ngā e përgjakta Fushë e Shtojt,
ç' ushton natën psherëtimash
djelmërije të shuame heret;
e ngā Bardhaj, e ngā kodrat
përtej Kirit t' shungulluame;
ngā Bêrdica te ku i Dibrës
u rrit nami e i Isuf Begut;
ngā i lëvdoshmi Tarabosh,
e ngā Qyteza e uruarë
ngaha Mirkoja edhe shkuli
kot luanin e Shên Markut,
do të çohet mbi të tjera
e me kohën do t' zmadhohet
kênga e lartë e lëvdîs sate
për t' u ndier te bota e têrë,
o i pashoku Esad Toptani!

δ 75 rjepur,‖ rrjepur, KT 86 kodrat‖ kodhrat KT

ε 88 Bërditsa sic AB — 95 smadhohet AB.

fu travolto Hasan Riza,
slealmente assalito nel buio
dietro le spalle, come usi
tu, o vile! Quel denaro
invano l'hai speso, poiché al posto
di quel bruno sparviero di Bagdat,
ti sta di fronte il nato di aquila:
il figlio dell'aquila ti sta di fronte,
o maledetto gufo della notte,
per spennacchiarti, per scorticarti,
per fiaccarti e braccia e dorso,
prima ancora di penetrare nel nido,
in quel nido regale
che con meraviglia di lontano
vide il Sultano Maometto Secondo,
e dove per buona fortuna
tu troverai la tua rovina!
Dalla pianura insanguinata di Stoi,
che la notte risuona di gemiti
di gioventù spenta anzi tempo;
e da Bardhai, e dalle colline
di là dal Kiri sconquassate;
da Berdizza, in cui di Dibra
si accrebbe la fama di Isuf Bey;
dal glorioso Tarabosh
e dalla fortezza augurale
da cui Mirko svelse
invano il leone di S. Marco,
si leverà sopra le altre
e col tempo si ingrandirà
l'alta canzone della tua gloria
per risuonare nel mondo intero,
o incomparabile Esad Toptani!

VI

Të shpifura

Mili i tha: – « Për i gëzuar,
û jam tepër i gëzuar
të t' kēm njohur dhe për faqe,
o Pasha; përse ngā zêri
tash kā mot ç' edhe e kam gjegjur
êmbrin tênt të plot me ndēr,
po mê shumë çë ngā dita
kūr i dolle Shkodrës zot,
e vllastār, si jē, u dëftove
të pamundurish luftarë,
gjak e fis me Skanderbegun».
E me gas atīj Esadi:
– « Këto fjalë, o trim, më bien
shum të kêndëshme te veshi,
e si vësa aqê e përiture
për mbi lulezit çë veshken,
njê pas tjatrës mua te zêmbra,
fort e fort e hidhëruame,
ato reshin tuke e zbuturë;
se të shpifura e të kalla
kundra meje nxuarën shumë
ngjēr më sot edhe s' u lodhën,
gjithë ata çë kam armiqë
mê ngā vêndi edhe ngā fara
se prej jashtit e të huajë.
Ndoshta edhe mb' at' anë t' dētit
midis jūsh do t' kēt arrënë
e helmuara frymë e resës
çë s' pushon as ditë as natë...»
Heshti pak tuke vërrejtur

δ 1 gëzuar,‖ gëzuar! KT 2 û‖ U KT 18 hidhëruame, ‖ hidheruame, KT

ε Napoli, 27 luglio 1916

VI

Calunnie

Milo gli disse: – «Sono lieto!
Io sono molto lieto
di averti conosciuto anche di persona,
o Pascià, poiché per fama
è da tempo che ho inteso
il nome tuo onoratissimo,
ma ancora più da quel giorno
in cui hai difeso Scutari,
e virgulto quale veramente sei, ti sei dimostrato
di invincibili guerrieri,
consanguinei e parenti di Skanderbeg».
E sorridendo a lui Esad:
– «Queste parole, o giovane, mi suonano
molto gradevoli all'orecchio,
e come la rugiada tanto attesa
sovra i fiori che avvizziscono,
una dopo l'altra a me nel cuore
fortemente amareggiato,
esse scendono placandolo;
poiché calunnie e insinuazioni
contro di me ne crearono molte
fino ad oggi e senza posa
tutti quelli che mi sono nemici:
calunnie sorte più in Patria e fra i connazionali
che all'estero e fra gli stranieri.
Forse anche di là dal mare
in mezzo a voi sarà anche giunto
l'avvelenato soffio dell'invidia,
che non riposa né giorno né notte… ».
Tacque per poco, scrutando

30 sŷ ndë sŷ, si me t' shqyrtuam;
e me qênë çë përgjigjen
nuk e nxirte prej fytyrës
t' atij trimi t' përkujtuashëm,
prap e nisi, si me t' zymt
tuke thênë: – «Û fort të lutem
të m' kallzosh edhe të têrë
të vërtetën: Se çë mênde
bota kanë atje për mua?
A i besojën vall përrallat
çë po qiten ?... Fol pa m' fshehur
mosgjê fare, t' jëm i zoti
t' i dëftonj të rrëme t' gjitha
e përpara teje s' pakut,
se i të shumëvc jë shpŷrti».
Edhe Mili: – «Mbi të madhin
kot të poshtërit përflasin,
jo mbi njerëzit e liqë,
për të cilët jetë e dekë
nuk ndryshojën, se për njerën
si për tjetrën ashtu heshtet,
sā si kūr se ata në dritë
s' duallën kūrr. Pas fjalës s' vjetrë,
rron i miri sā do i keqi.
Po në kŷ te dora e vetë
jetën kā të kurmit t' rāshëm
përse edhe me faqe t' zezë
munt t' e vrasënj' kūr i teket
prapa krahëvet me thikën,
a me pushkën prapa gardhit,
nuk kā fare atê të namit,
ç' êsht edhe si jeta e shpyrtit,
e mê t' shumën, si për herë

δ 31 ndë sŷ, si me t' shqyrtuam;‖ ndë-sŷ, si me t' sqyrtuam; KT 53 vjetrë,‖ vjetre KT 58 kūr‖ kur KT 62 shpyrtit, ‖ shpirtit, KT

ε 57 edhé om. B, appena leggibile in A — 58 vrasënjë B. 61 fare A, om. B.

occhio nell'occhio, come per indagare;
e poiché la risposta
non traeva dall'aspetto
di quel giovane rinomato,
di nuovo riprese quasi con mestizia
dicendo: – «Io ti prego caldamente
di svelarmi per intero
la verità. Che opinione
la gente ha colà di me ?
Credono forse alle invenzioni
che sempre spuntano ?... Parla senza nascondere
nulla affatto, in modo ch'io sia in grado
di dimostrar che tutto è menzogna:
di dimostrarlo almeno innanzi a te,
che di molti sei l'anima».
E Milo: – «Gli abietti
sparlano invano su chi è grande,
non sugli uomini cattivi,
per i quali vita e morte
non differiscono: e sia per l'una
come per l'altra si tace
come se mai essi
fossero nati. Giusta il detto antico:
"Vive il buono quanto vuole il malvagio".
Ma se questi ha in suo potere
la vita del corpo caduco,
poiché malvagiamente
può ucciderlo quando lo voglia,
dietro le spalle col pugnale,
o col fucile dietro la siepe,
non ne ha tuttavia la fama,
che è anche vita dello spirito,
e che il più delle volte

e këtīja ajo fillesën
e kā vetëm kūr njeriu
sŷt i mbyll të bardhit diell.
Mun më duket prā e disāve,
se edhe i gjitheve të vêndit
për të dashtur ê pëlqimi
në lëvdī. Këjo e kërkuame
mirakêndë s' i mohonet
ditëshkurturit të ngrat
ç' as të dêndurë as të gjêrë
mê s' e ndën mbi tjerët hien,
po ç' i mledhur rrī më nj' anë,
si kush rrogë t' punës s' tīj
nuk përet e nuk do tjatërë
veç se t' prëjtur. Atê herë,
po atê herë, as mê, i lëvdoshëm
êsht për gjithë, e pa përpose,
burri i mirë, edhe n' i mirë
e i lëvdoshëm mê se kūr
êsht i njohur brênda varrit,
te ku i gjën edhe të keqit,
a i mbështet atīj si i kêndet
ndo çëmim e n' gūr ja shkruan,
dhimë e blême trashgimtāri
a të t' bijëve t' bînduar,
a e të butëvet ndëlisa.
Po si s' mirren sŷt e gjîndes
me shkëlzim të vezullojës,
ashtu edhe me shosh nuk fshihet
drita e diellit. Prān ngā t' shārat
mos kujdesu e ngā të kallat
se mbi atê ç' i qet këthehen
dhe e plakosin. Fryma e resës,
nuk bên dot që t' thahet lāri,

δ 76 tīj‖ tij KT 96 Fryma‖ Frima KT

ε 80 përpose A, pëpose B.

è solita incominciare
solamente quando l'uomo
chiude gli occhi al bianco sole.
A me e a diversi
come a tutti i conterranei
può sembrare che il piacere della lode
sia da temere. Questa ricercata
soddisfazione non si nega
all'infelice mortale
che nei confronti degli altri
non stende un'ombra né più larga né più stretta;
ma che raccolto sta in un angolo,
come colui che a mercede della sua opera
non attende e non vuol altro
se non il riposo. Allora,
solo allora, e senza eccezione, lodato
è da tutti, e senza riserve,
l'uomo dabbene; e ancora migliore
e degno di lode più che mai
è riconosciuto dentro la tomba,
dove egli trova anche i cattivi.
Allora gli attribuisce a suo piacimento
qualche lode e gliela incide sulla pietra,
il dolore comprato di un erede
o di figli ubbidienti,
o l'indulgenza dei mansueti.
Ma come non si accecano gli occhi della gente
con lo splendore della luce,
così del pari con lo staccio non si nasconde
la luce del sole. Quindi delle ingiurie
non aver cura, né delle calunnie,
poiché su chi le lancia esse ricadono
e lo abbattono. Il soffio dell'invidia
non fa seccare l'alloro,

po mẽ t' gjelbëra e të njomë
ja bẽn gjethet, edhe rrênjët
mẽ të forta e të shëndoshta.

δ 99 ja‖ j-a KT

ma più verdi e più teneri
rende ad esso i germogli e le radici
più forti e più robuste ».

VII

Vrasëja e Hasan Riza Begut

Ngā të parët i ndigjuam
kështu fliste Esad Toptani
mẽ të madhe rëndësī:
– «S' ishëm miqë, ashtu si fjala
ndër nē njihet, as armiqë
unë edhe Hasan Rizāja;
po na shkojëm pa u përpjekur
tek e gjêra rrugë e jona,
e të dy si shok me shokun,
kishëm njêri ndēr për tjetrin.
E të dy me të vërtetë
me t' palodhurit ushtārë
na mundoheshim, pas dojes,
për me i prēr furin e hovin
të pashpȳrtit, ç' u lëshua
e mbi Shkodrën rā si dredhë,
për mëri në farën tênë,
për mëri çë kūrr nuk shuhet,
e për njê dëshir të flakët
çë po i djeg të thatën zêmbërë
për të pasurat e botës.
Vjedharak edhe i pabesëm,
i përetur āri e gjaku,
do të jēt me kohë i njohur
kūr të shesnjë edhe i pabesëm,
tuke sjellë sā të duket
kūj kā sȳ për të mos pār,
si ngā fati i keq i ndrydhur.
Po ngā gjithë i bêr n' asgjê,
i harruam edhe ngā fisi,

δ 18 kūrr] kurr KT 25 kūr] kur KT

ε Napoli, 31 luglio 1916 Tit. Hassan e Hasan: il P. oscilla fra le due forme.

VII

L'uccisione di Hasan Riza Bey

Dai notabili ascoltato
così parlava Esad Toptani
con grande serietà:
– «Non eravamo amici, nel senso che noi
usiamo dare alla parola, né avversari
io e Hasan Riza;
noi camminavamo senza incontrarci
per la nostra larga strada,
ed entrambi come compagni
ci rispettavamo a vicenda.
Ed entrambi veramente
con gli infaticabili soldati
ci sforzavamo, giusta il dovere,
per spezzare la violenza e la foga
del crudele, che si slanciò
e sopra Scutari piombò come una tempesta,
per odio contro la nostra razza,
per odio che mai non si spegne,
e per la brama ardente,
che gli brucia il cuore spietato,
per i beni della terra.
Ladro e sleale,
assetato di oro e di sangue,
sarà in seguito conosciuto,
quando si comporterà ancora da spergiuro
e in modo da sembrare,
a chi ha occhi per non vedere,
perseguitato dal fato avverso.
Ma da tutti ridotto al nulla,
dimenticato anche dalla sua gente,

do t' jetonjë i zī mbi vehten,
si një shpȳrt; edhe pas dekës
bashk me kurmin ësht i lidhur,
për me ndier të halinoset
në ndeshkim se e deshi tepër.
Po një mijë gjellë t' kishte
për me u shkulur ndër mundime,
a, më keq, për të xarrisur
me pahīr në turpë e dhunë,
nuk mjaftojën dot të lājën
ata faje çë po bêri
e ata gjake çë derdhi!
Të mëndērshëme llumbardha,
tue gjêmuar e ditë e natë
mbi qytetin ngā gjith anët,
po me bumbë e brumbullaqe,
çë pëlcisnin mbi pullazet
midis rrugavet, te qishët,
ndë kopshtinjë e në faltōre
hidhnin zjarm e prish e deke.
O sā grā edhe sā fëmijë
gjetën varr të papëritur
ndër rrenime të ata vênde
te ku rrijën tuke dridhur,
tuke qār e tuke u lutur!
Nuk pushonte kūrr lurima
trëmbësōre ngā të nxehtat
grykë t' hekurta si zêmbrat
e të bijëvet të Malit
me të drejtë i thênë i zī.
Po çë prān? Qëndronte Shkodra,
ndonse zû t' pakonej buka,
e nuk tundej dot qiteza
ndonse t' lypsurat gjintojën.

δ 42 gjake]] gjakje KT 43 Të mêndērshëme llumbardha,]] Ta mëndērshëme lumbardha, KT

vivrà infelice in se stesso,
come un'anima che anche dopo morte
è legata insieme al corpo,
per sentirsi distruggere
nel castigo ben meritato.
Che se avesse mille vite
da trascinare in tormenti,
o ancor peggio da trascorrere
contro voglia fra vergogne ed affanni,
non basterebbero mai per lavare
quei delitti che commise
e quel sangue che effuse.
Formidabili cannoni,
tuonando e giorno e notte
sulla città da ogni lato,
con bombe e proiettili
che scoppiavano sui tetti,
nelle strade, nelle chiese,
nei giardini e nei santuari,
versavano fuoco, rovina e morte.
O quante donne e quanti bambini
trovarono tomba inaspettata
tra le rovine, in quei posti
dove stavano tremando
e piangendo e pregando!
Non cessava mai il rombo
spaventevole dalle ardenti
bocche di fuoco, dure come i cuori
dei figli del Monte
giustamente chiamato nero.
Che poi ? Resisteva Scutari,
benché incominciasse a scarseggiare il pane,
e la cittadella rimaneva salda
pur aumentando i bisogni.

Thot armiku vet me vedin:
– "Për atê të lum Shên Pjetër
çë na kemi gjysh të dashur,
duhet vrar Hasan Rizāja,
tuke i sjellë marre Esadit,
për me qitur spica n' Shkodrë,
e me i futur çartën brênda".
Ashtu tre vrasōrë t' shiturë
nd' errësirë atê përitën,
si po dilte prej shpīs time,
te ku thirrë e kisha n' tryesë,
tuke e pasur prān te besa.
Krisi pushka dȳ trī herë
e vajtuashme n' gjî të natës.
Zêmbra m' foli: – "E vrān Hasanin!"
U lëshova jasht si i marrur
me pas tjerë e njê kallogjer.
Bînte shī, e s' voglës dritë
të fenērëvet, ndër balta
trimin pām edhe të gjāll.
Dal' e dalë n' anë e qēllem
dhe e vênduam te shtrati i bardhë.
– "Kī shpëresë, o beg, se Zoti
êsht i math..." E ai tue qeshur:
–"Që ta shoh, pasha, po nisem...
M' arrû hera!... Thuaji djalit,
djalit tim se rāsh të lufta...
Êsht i vogël e në ndihmë...
T'e lẽ tȳj... E ju t' qëndroni
burra t'fortë! Êsht koha e ndērit...
O Bagdad... O biri i jim!..."
– "Shko (thash unë), ō shpȳrt i math,

δ 68 Hasan‖ Hasān KT 89 ta‖ t'a KT

ε 76 In A dopo il v. 76 si leggono questi versi, poi cassati e non copiati in B: «è m'i rân kur mbeti i vetëm, — përsè rojën nuk e deshi, — è ndimtàrit, çë prej meje — e persillte, i fali rrugën —». È strano che il P. abbia espunto questi versi molto importanti. 96 shȳrt AB.

Dice il nemico tra sé e sé:
– «Per quel beato San Pietro,
che noi abbiamo come avo amato,
è da uccidersi Hasan Riza,
recando onta ad Esad,
creando difficoltà a Scutari,
accendendovi dentro la discordia.
Così tre assassini venduti
nel buio lo attesero,
mentre usciva dalla mia dimora,
dove invitato lo avevo a tavola,
avendolo poi sotto la mia protezione.
Rombò il fucile due o tre volte,
cupo nel cuore della notte.
Il cuore mi parlò: "Hanno ucciso Hasan!"
Mi slanciai fuori come un folle
con altri e fra essi anche un frate.
Pioveva e, alla fioca luce
dei fanali, nel fango
trovammo l'eroe, ancora vivo.
Pian piano lo portammo in casa
e lo posammo sul bianco letto.
– «Abbi speranza, o Bey, ché Iddio
è grande…». Ed egli sorridendo:
– «Vo' vedere, pascià, ma sento che parto…
Mi è giunta l'ora!… Dì al figlio,
al figlio mio che caddi in battaglia…
È piccolo ed ha ancora bisogno di aiuto…
Lo affido alla tua protezione… E voi resistete
da uomini forti!… È l'ora dell'onore…
Oh Bagdad…, o figlio mio!… »
– «Trapassa (diss'io), o anima grande,

shko pā brêenga e pā kujdese
se e kam urdhër fjalën têende!
Dhe bêenj bē se uhān e gjakut
do t' t'e marr me faqe t' bardhë"».

passa senza dolori e preoccupazioni,
la tua parola per me è un ordine!
Io ti giuro che il debito del sangue
lo salderò con onore».

VIII

Qëndrimi

Kështu fliste Esad Toptani:
– «Unë e dija e se të rêndë
për mbi krahë e kisha barrën;
po atê herë u vet te shpyrti
njê fuqī të rē të madhe
ndieja edhe, çë tue më rritur
të pathyemen besë n' vehte
mua më shtonte edhe guximin
çë të tepër kam ngā t' lēmit
për me i ndenjur Orës m' ballë
burrërisht. As u gënjeva
se ngā fati domosdoshëm,
prej rrethimit ngā gjithë anët
mê t' shtrënguashën se mê para,
kisha Shkodrën me e shpëtuarë;
po i gëzonesha shëllimit
se t' dy rregjërash pushtetin,
ç' egërsonej pā të drejtë
kundra nësh e shpivet tona,
do t' e grisëja e të poshtër
do t' e bëja n' sȳ të botës
me qëndresën trimërōre
mê të gjatë e të përgjaktë,
jo për ndēr të gjymsës s' hênës
po për 'tê të shqypes t' vjetrë;
jo për êmbër të Sulltanit,
po për nam të dheuthit tênë!
Të mallkuara edhe ngā gurët
do të hījën prān në Shkodrë,
po të lodhëta e të sosëta,

δ 4 shpyrti ‖ shpirti KT 9 tepër‖ teper KT 25 shqypes‖ shkypes KT vjetrë;‖ vjetërë; 29 hijën‖ hijën KT Shkodrë‖ Shkodërë KT

ε Napoli, 3 agosto 1916 13 gjithë om B.

VIII

La resistenza

Così parlava Esad Toptani:
– «Io sapevo che grave assai
sulle mie spalle avevo il peso;
ma allora nell'animo
una nuova e grande forza
mi sentivo, che, aumentandomi
l'infrangibile fede,
in me accresceva l'audacia,
che ardente ho dalla nascita
per resistere di fronte al Fato
virilmente. Né m'ingannai
che per destino inevitabile
dall'assedio, che da ogni parte
si stringeva più rigoroso di prima,
avrei liberato Scutari;
e mi rallegravo al pensiero
che di due re la possanza,
che inferociva senza diritto
contro di noi e le nostre case,
avrei infranta e prostrata
di fronte al mondo,
con la resistenza eroica,
assai lunga e sanguinosa:
non per onore della mezza luna,
ma per quello dell'aquila antica;
non per il nome del Sultano,
ma per la fama della nostra Patria!
Maledette anche dalle pietre
sarebbero poi entrate a Scutari,
stanche e sfinite,

ato tubë t' laskaruame
malatakësh e barīsh
në ballë ulqish të rrëmuja;
do të hijën t' rralluara
e me frymë të këputurë
për me pār, po ashtu si n' ênderrë
atê vênt te ku kujtuan,
pas të thênavet të rregjit
se do t' prêheshin, ndë vonë,
për mbi shtretëra të butë;
se do t' kishën shpī të mira,
bukë e krypë e verë t' êmbëlë,
edhe vashazë të bardha.
Të më dilte puna e mbarë
do t' mundonej kot armiku,
e do t' tretej e t' faronej
si kusār çë bie n' gërgile
do se i vrār do se i varruam
ngā të zotërat e shpīs
çë mesŷjti për të vjedhur
bashk me shokët ndë mes natës".
Këto rrihëja ndë mênt
vet me vedin, po me t' shumë
nuk e çela dot këshillin,
se do t' ruhesha ngā Turqit,
e të vêndit prej disāve
myslimanë e të krështerë,
dhe më tepër se ngā Turqit,
tuke e dītur se si t' verbërë
janë ata prej fevet t' tyre,
e se s' bindin, as përkulen,
në mos qofshin te njê grusht.
Me t' vërtetë û kisha t' Dibrës
të pamundurit fatosa,
edhe kisha disā burra
si të motit, prej t' rrëmbŷeshmit
diell të luftavet të djegurë,
çë ngā zêmbra e Shqipërīs

quelle torme affamate
di selvatici e di pastori,
come branchi scompigliati di lupi;
esse sarebbero entrate sparpagliate
e con respiro affannoso,
per vedere come in sogno,
quel luogo, ove immaginavano,
secondo le promesse del re,
che si sarebbero riposate alfine
sovra letti soffici;
che avrebbero avuto case comode,
pane e sale e vino dolce,
e bianche fanciulle.
Se mi fosse riuscito il disegno
vani sarebbero stati i conati del nemico:
ed egli si sarebbe logorato e distrutto,
come ladro che cade nell'agguato,
ucciso o ferito
dai padroni della casa,
che assalì per derubarli
insieme ai complici nel cuore della notte.
Queste cose volgevo per la mente,
tra me stesso, ed a molti
non aprii il mio consiglio,
poiché dovevo guardarmi dai Turchi.
Ma da molti altri del luogo,
musulmani e cristiani,
dovevo guardarmi ancora più che dai Turchi,
ben sapendo che come ciechi
sono essi per le loro religioni,
e che non si piegano e non si assoggettano
se non sono tenuti in pugno.
In vero io avevo di Dibra
gli invincibili campioni,
e avevo tanti uomini
simili agli antichi, dall'ardente
sole delle battaglie bruciati,
che dal cuore dell'Albania

m' erdhën pas e m' rrîjën n' dorë
si edhe shpata. Çë do t' bëja,
çë munt t' bêja me ata vetëm,
mê se t' vriteshim të gjithë,
për t' i shtuar ashtu gëzimin,
kūr dëshiri i fort t' i mbushej
për të keqe të Shqipërîs,
faqezīut të bīr të Shkinës ?
Mlodha at' herë krênjë e t' parë
t' ushtërîs e të qytetit
edhe thash: – "Ësht dojë e jona,
e njê dojë e pa shpëtoshme;
do si njerëzë të mirë,
do si ushtārë çë nuk tuten,
t' i qëndrojëm Shqāut përpara
ngjēr çë t' kemi gjak e shpȳrt,
mos t' i lêm shtëpīvet marre,
tuke u dhênë atīj në dorë,
të na kēt ai si dele
çë kanāri ka të thērnjë
pas dëshirit. Po t' e dīni
se thot fjala e farës time
se na s' ipemi të gjāllë;
prān ju thom se i math e i vogël
do të shkoni në llagōrë,
kush për luftë e kush të rënët
për të mledhur, në mos tjatër,
e mê i barturë n' qytet
për të duhurit kujdesë.
Në të mrâme n' mênt ju siell
se luftonet sot për ndērin,
e se s' dhash dȳ herë nj' urdhër!»

ō 84 shpȳrti ‖ shpīrti KT

mi seguirono e mi ubbidivano
come la spada. Che avrei fatto,
che mai avrei potuto fare con loro soli
se non farci tutti uccidere
per accrescere così la gioia,
quando il forte desio gli si fosse appagato
ai danni dell'Albania,
dello svergognato figlio dello Slavo ?
Radunai allora capi e condottieri
dell'esercito e della città
e dissi: – "È un dovere il nostro,
e un dovere imprescindibile,
sia come uomini dabbene
sia come soldati che non temono,
resistere allo Slavo,
finché avremo sangue e anima,
per non lasciare onta alle case,
arrendendoci alle sue mani,
perché ci abbia come pecore
che il macellaio scannerà
quando lo voglia. Ma sappiatelo
che il motto della mia casa dice:
Noi non ci arrendiamo vivi !'
Poi vi dico che capi e gregari
andrete in trincea,
chi per combattere e chi per raccogliere,
se non altro, i caduti
e trasportarli in città
per i soccorsi necessari.
In fine io vi ricordo
che oggi si combatte per l'onore,
e che un ordine non l'ho dato mai due volte"».

IX

Të ngam

Kështu fliste Esad Toptani:
– «Çë ngā e para ditë e Shkurtit
ngjër më ditën e Shên Gjergjit
kūrr i bishavet t' Cetinjës
e t' Belgradit hidhërimi
nuk u ndal se mê po shtonej
edhe bênej mê i tmeroshëm
më të zgjaturit e kohës;
mê se mê kūr Malisorët,
tuke par të mikut t' rrēm
djallësīt edhe pabesën
mbrapështīn e t' zezën zêmbërë,
rān në fije e m' anë u hoqën
në mejtim, po edhe në rôjë.
Lufta n' Pleshë e n' Babë e n' Pistull,
në Bushat e Barbullush,
në Bêrdicë e në Shirokë,
në ç' do vênt të Taraboshit
e në Rrenc e n' Fushë t' Shtojt,
çë mûnt t' thuhet Fusha e Gjakut
e mbi Ksīs e n' Bardhanjoll,
na dëftuan se rrethi i hekurt
mê ngushtonej rrotull nësh
e se mbyllej të na mbyste.
Pjetri, Mirkoja e Danili,
si ngā Stajka, si ngā Boksi
si ngā kreshta e Taraboshit,
për njê muaj edhe dỹ javë
nuk u lodhën ditë e natë
tuke hedhur pa pushim
dredhe bumbësh mbi qytetin,

IX

Provocazione

Così parlava Esad Toptani:
– «Dal primo giorno di febbraio
fino al giorno di S. Giorgio,
mai delle belve di Cettigne
e di Belgrado la rabbia
si fermò, ché anzi più aumentava
e diventava più tremenda
col prolungarsi del tempo;
e ancora più quando i Malisori,
vedendo del mendace amico
le trame, la falsità,
la perfidia e l'anima nera,
avvertirono l'inganno e si trassero da parte
ponderatamente e in guardia.
Battaglie in Plesh e in Lab e in Pistull,
in Busciati e Barballusci,
in Bardiza ed in Sciroca,
e in tutti i punti del Tarabosh
e in Brenz e nella pianura dello Stoi,
che può appellarsi il Piano del sangue,
e sopra Csia e in Bardagnoli,
ci dimostrarono che il cerchio di ferro
più si stringeva attorno a noi,
e che si chiudeva per soffocarci.
Pietro, Mirko e Danilo
sia da Staica e da Boksi,
come dalla giogaia del Tarabosh,
per un mese e due settimane
non si stancarono giorno e notte
di lanciare senza tregua
nugoli di bombe sulla città:

mbi atê Shkodrë të ku thonë,
porsa i plasi dëlli i marres,
se të t' parëvet të tyre
varret janë t' paharruamë.
Cilët qenë ata të parë?
Sŷt i lagëshin me lotë,
si po xûra prej disāve,
për gëzim të math të lumit
plak të t' jatit, kūr te tryesa,
me të ngrênë mish të mājm
dashi t' tredhur edhe qêngji,
tuke pīr rakī edhe verë,
verë t' kuqe edhe të vjetrë,
ndinte punët e lëvdoshme
të të bījëvet: –"Çë djelmë,
e çë trima, hie të botës!...
Nuk i lanë atīj njê qime!"
Tek e treta ditë e Marsit,
pas njī natëje efshi e dreje,
për at' breshër të mêndërshëme,
erdh' e m' gjeti Plamenaci:
– "O Pasha, na u jip në dorë!"
– "S' kē të drejtë, o plak, për Zotin!,
të më dīsh aqê të poshtër".
– "Po ti Shkodrën merr në qafq
se s' do t' lêm as gūr mbi gūr".
– "Më çë bêni të keqīa
më na ndahij e largonij.
Nder nē e jū njê gropë e thellë
êsht e hapurë, e për dita
më thellonet e zgjeronet
sā edhe kūrr nuk kā me u mbushur.
Qoft ashtu për fatin tênë!"
– "Po na Shkodrën do t' e marrim

δ 36 Cilët ‖ Tsillët KT 40 tryesa,‖ trjesa, KT

ε 63 nuk A, om. B.

su quella Scutari, ove dicono
-- poiché hanno perduto ogni ritegno –
che dei loro antenati
ci sono le inobliate tombe.
Chi furono quegli antenati ?
Si bagnavano di lacrime,
– come appresi da alcuni –
per la grande gioia, gli occhi del felice
vecchio padre, quando a tavola,
mangiando carne grassa
di castrato e di agnello,
bevendo poi acquavite e vino,
vino rosso e anche vecchio,
sentiva le azioni lodevoli
dei figli: – "Che giovani
e che eroi, decoro della terra!...
Somigliano a lui perfettamente!
– "Nel terzo giorno di Marzo,
dopo una notte di terrore e di spavento
per quella grandinata spaventevole,
venne a trovarmi Plamenazi:
– "O Pascià, arrenditi!"
– "Per Dio! non hai diritto, o vecchio,
di ritenermi cotanto basso.
– "Ma tu rovini Scutari,
poiché non lasceremo pietra sopra pietra".
– "Più male voi oprate
e più da noi vi staccate e vi allontanate.
Tra noi e voi un profondo abisso
è scavato, e giornalmente
esso più sprofonda e si allarga,
e mai più si colmerà.
E sia così se questo è il nostro destino!"
– "Ma noi Scutari la piglieremo

do mos do. Pa atê nuk rrojëm".
– "Vdisni prān, se nuk e kini!
Kūr t' ju duket e pushtuarë,
do t' shpëtonjë ajo mê shpejt,
si ngā prishëja e rrenimit
do të çonjë kryet e ndērshëm
Shqipëria..." – "Po ti jē Turk!..."
– "A të dukem? Êsht mê mirë
të jēm Turk, se t' jēm gjaktōr,
vrasës foshnjësh edhe grāsh..."
– "Mos të mirremi mê t' ashpër,
o Pasha. S' na rrī ti m' ballë
e s' lufton në vênt të Turkut?"
– "Mua më thonë Esad Toptani
ngā Tyrana; prān, prej Zotit,
jam Shqiptār". – "E kūr u bêre?...
Dua të thom: Kūr u kujtove
se jē i till ?" – "A do t' e dīsh ?
Kūr u turrën mbi dhē tênë
tuba t' egërish mizōrë
për të vjedhur, për të rjepur,
për të vrār e për të djegur,
për të sjellë marre e dhunë
shpīvet tona, edhe të huajë
për të bêr te toka e dashurë
mua të parin me të tjerët..."
– "Le të jēt!... Po edhe prej Nemces
patëm na pëlqim e lēje
të vêndosemi në Shkodrë".
– "A ti thua ?... Ja dhat Lofçenin ?..."
– "Êsht njê gūr i paçëmuam
ai mal e nuk e japim..."
– "Për sā prān ja kini shitur?..."
Ûnji kokën plaku i zbēt,
kokën ûnji e mê nuk foli».

δ 98 ja ‖ j-a KT

ad ogni costo. Senza di essa non viviamo."
– "Crepate pure, ma non l'avrete!
Quando vi sembrerà conquistata,
vi sfuggirà ancor più presto:
e nello stesso modo dallo sfacelo della distruzione
solleverà la testa onorata
l'Albania..." – "Ma tu sei turco!"
– "Ah, ti sembro ? È ancor meglio
essere turco che sanguinario,
uccisore di bambini e di donne..."
– "Non ci prendiamo con asprezza,
o Pascià. Non sei tu che ci stai di fronte
e non sei tu che combatti al posto del Turco ?"
– "Io mi chiamo Esad Toptani
da Tirana; poi, grazie a Dio,
sono albanese". – "E quando lo divenisti ?
Intendo dire: Quando ti sei ricordato
di esser tale ?" – "Lo vuoi sapere ?
Quando si precipitarono sulla nostra terra
orde di selvaggi barbari
per rubare, per scorticare,
per uccidere e per bruciare,
per recare onta e disonore
alle nostre case, e stranieri
renderci nell'amata terra,
me per primo insieme agli altri..."
– "Lascia che vada così!... Anche dall'Austria
abbiamo avuto il consenso e il permesso
di stabilirci a Scutari".
– "È così ?... Glielo avete dato il Lovcen?"
– "È una rocca inestimabile
quel monte e non lo diamo..."
– "Per quanto, dunque, l'avete venduto?..."
Abbassò il capo il pallido vecchio,
il capo abbassò e più non parlò».

X

E kūr ?

Kështu fliste Esad Toptani:
– « Ngā njê ditë e rē çë shkonte,
ish njê hap çë rënd pas rëndit
po zmadhonej për në t' sosur,
përse zhgrehej si njê trûjë
çë harmonet dal' e dalë,
gjithë ajo fuqī qëndrimi
ç' u dëftua ngā mê të shumët
kūr e nisëm për se dÿtit
t' ashprën luftë. Û vet at' herë,
tuke zênë t' lartin urdhër,
shpyrtin tim te shpÿrti i tÿre
kisha frÿtur, bashk me besën
çë më mbante, edhe të ndriturë
me shpëresa t' parrëfyeme
çë prej zêmbrës të ngā njêrit
pas dëshīrëvet shkreptinin.
Po mbi gjithë e rênda e motit
kishte rār si napë e vrêrëtë,
e në zī po dukej ora
sā dÿ herë edhe mê e gjatë.
Me të but mê se mê t' ashpër,
po pa t' luar e pa ndyshime,
u përpoqa për me u sjellë
si mê i zot se edhe shtrëngesa
ngjër çë mênda, ndonse e keqe
nuk ndalonej kūrr rrëpira
zjarmi e hekuri mbi Shkodrën,
me ato gjêmë për me u çmëndur;
edhe ndonse për të gjithë

δ 17 dëshīrëvet‖ dhëshīrëvet KT 40 tryesa,‖ trjesa, KT

ε Napoli, 9 agosto 1916 15 të AB.

X

E quando ?

Così parlava Esad Toptani:
– «Ogni nuovo giorno che trascorreva
era un passo che di grado in grado
si allungava per condurre alla fine:
poiché si logorava come una torre,
che si sgretoli a poco a poco
tutto quell'impeto di resistenza
che i più avevano manifestato
quando iniziammo per la seconda volta
l'aspra guerra. Io solo allora,
assumendo il supremo comando,
il mio animo nell'animo loro
avevo inspirato, insieme alla fede
che mi sosteneva, alimentata
da speranze inesprimibili,
che dal cuore di ciascuno,
giusta il desiderio, erompevano.
Ma soprattutto il rigore della stagione
si era abbattuto come un negro velo,
e nello stento l'ora sembrava
lunga quanto il doppio e ancora più.
Con mitezza più che con asprezza,
ma con serietà e senza debolezze,
mi sforzai di rendermi
più forte della stessa necessità
finché potei, poiché terribile
non cessava mai la tempesta
di fuoco e di ferro sopra Scutari,
con quel fragore da far impazzire;
poiché anche per tutti

bênej hâja fort mê e rrallë,
po si vaj të njî hërnâri
çë për shumë ndênji i dhezur.
Si të bênej prân? – "Të vdesim
trimërisht!" më tha njê ditë
Ali begu i Dibrës s' madhe.
– "Jo, ore beg; se koha e dekës
s' erdhi edhe për nê. T' qëndrojëm
edhe pak, të bîndet bota
se këtu lufton Shqiptâri
për shëndet të vêndit t' vet.
Do të sillemi mê vonë
pas të duhurit… Njê t' vetme
gjê të thom, se n' dorë t' huajë
s' do t' e lêm të plirën shpatë,
vaft edhe si kâ për t' vatur
puna nestër! Êsht e diturë
se njê dekë n' shesh të ndêrit
êsht mê e mirë e mê e kërkoshme
se ngâ armiku jeta e dhênë
me t' përbuzur e krenî,
a me t' mirë e me të dhimtur
kuj ju lut për 'tê pa folë
tuke u shtruar!" Më tha: – "T' u lumt
goja, o pashë! Atê çë thua
na do t' bëjëm, porsa tŷj
kemi t' pâr e ti kê barrën
e të mirës tênë e t' vêndit.
Shkojën ditë e shkojën natë
e kështu trî javë tjera
dhe në gjî më qirej zêmbra
si po shihëja t' patundur,
po të lodhëtë e të zbêtë
ata trima t' mî n' llagorë,
ku mê s' dîjtin shîje t' bukës,

δ 53 ju‖ j-u KT

diventava il vitto sempre più scarso,
come l'olio di una lampada
che a lungo stette accesa.
Che restava dunque di fare ? – "Moriamo
eroicamente!" mi disse un giorno
Alì beg di Dibra Grande.
– "No, o beg, ché l'ora della morte
non è giunta ancora per noi. Resistiamo
ancora per poco, perché si persuada il mondo
che qui combatte l'Albanese
per la salvezza della sua Patria.
Ci comporteremo più tardi
secondo il bisogno… Solo una cosa
io ti dico: in mano straniera
non lasceremo l'insanguinata spada:
domani la vada come la vada !"
È risaputo
che una morte sul campo dell'onore
è migliore e più ricercata
che la vita data dal nemico
con disprezzo e con orgoglio,
o con mitezza e con dolore
a chi lo pregò per essa, sottomettendosi
senza parole ! Mi disse: – "Benedetta
la tua bocca, o Pascià! Quel che tu dici
noi faremo, poiché te solo
abbiamo per capo e tu hai il peso
del bene nostro e della Patria".
Trascorrevano giorni e notti
e così altre tre settimane,
e in petto mi si squarciava il cuore
vedendo irremovibili,
ma sfiniti e emaciati
quei miei eroi, nella trincea,
ove non conobbero più il sapore del pane,

e te ku nuk patën tjatër
që të hanin disā herë
jashta mishit kāli t' cofur.
Për urī si për të ftohët
zûn të vdisnin edhe shumë
të qytetit. U sos mielli,
u sos grûri, u sosën drût,
e ngā shpīt aqê të zeza,
ku moriteshin ndër lotë
e n' ankime grā të mjēra,
pleqë e cuca e kalamanjë;
te ku shuheshin ferishte
me t' pagjaktat buzë t' plasta
po të ngjitura mê kot
te të thatit gjinjë êmtāre;
ngā kopshtînjët e shkretuamë
e ngā rrugat, për në t' cilat,
si të verbërë e të dehurë
lonëdiseshin t' ûnshuamit
e rrëzoheshin ndër balta
e ndë lugje, te ku i dilte
shpȳrti i çārtur e i brêngosur,
po më dukej mua se çohej
si njê vāj e si njê lutë
çë më thoshte: – "E kūr ? E kūr ?"
Tuke ndênjur ndë qytezë
si përanë û ndieja hīet
të lëvdoshme t' Loredanit
e të të fortit Ndon të Lexhes
edhe atê të Mahmud Pashës;
e ndër lufta për mbi gjêmën
e llumbardhavet t' tmeroshme,
po te veshi e kisha vājin,
po te veshi e kisha lutën
çë më thoshte: – "E kūr ? E kūr ?"»

δ 83 vërbërë] vërbëtë KT

ε 71 miellit AB. 95 t' AB.

e non altro ebbero
tante volte da mangiare
se non carne di cavallo morto.
Per la fame e per il freddo
cominciarono a perire molti
nella città. Finì la farina,
finì il grano, finirono le legna,
e dalle case cotanto misere,
ove si struggevano in lacrime
e in gemiti povere donne
e vecchi e fanciulle e bambini,
ove spegnevansi infanti
con le pallide labbra screpolate,
attaccate invano
all'arido seno materno.
Dai parchi deserti
e dalle strade, per le quali
come ciechi e ubriachi
si trascinavano gli affamati
e si abbattevano nel fango
e nelle pozze, ove emanavano
lo spirito spezzato e sopraffatto dal dolore,
a me sembrava che uscisse
come un lamento e come una preghiera
che mi chiedeva: – "E quando ? E quando ?"
Stando nella fortezza,
le ombre a me sembrava di sentire attorno
gloriose di Loredano,
del forte Antonio da Lezze
e quella di Mahmut Pascià;
e nelle battaglie, in mezzo al rombo
delle bombe terrificanti,
nell'orecchio avevo il lamento,
nell'orecchio avevo la preghiera
che mi diceva: – "E quando ? E quando ?"»

XI

Besa

Kështu fliste Esad Toptani:
– «Prenc Danili i rregj Nikollës,
po si i thronit trashgimtār,
e si kryc për mbi ushtërīn,
hapi fjalën (e gëzimi
gjith i dukej ndëpër sŷt
e te zêri edhe ç' i dridhej):
– «Me lëvdī çë s' kā me u fikur,
o Pasha, përpara botës
u rrethove me t' vërtetë,
tuc qëndruar si trim i motit
ngjēr më sot… Çë do mê shumë?
Fatit ul të ngrehtit ballë
e kallxome me të paka
qyshket tatë edhe dëshīret,
se për fjalë nuk ê koha".
U pergjegja: – "Ng' ana e jime
edhe e gjîndes time t' dashurë,
për të cilën faqebardhë
unë dal, e prān të cilës
i përket mê i madhi ndēr,
Lartësī, të përhironj
për këto çë me të mirë
ti më thua, me gjith se armik,
te njê herë e jetës time
çë po kā për t' u përmêndur.
Dëshirimet edhe kushtet
tash digjo; pranoi, në dafshe,
e, në dafshe, miratosi,
grat të kemi të dŷ palët;
se ndomos në mênt e patshe

ε Napoli, 14 agosto 1916

XI

La tregua

Così parlava Esad Toptani:
– «Il principe Danilo, del re Nicola
come erede al trono
e come capo dell'esercito,
prese la parola, e la gioia
tutta gli traspariva dagli occhi
e nella voce che gli tremava:
– "Di gloria che non verrà mai meno,
o Pascià, davanti al mondo
ti sei circondato veramente,
resistendo come un eroe antico
fino ad oggi… Che vuoi di più?
Al Fato china la superba fronte
e manifestami brevemente
i patti tuoi e i desideri,
che non è tempo di parole".
Risposi: – "Dal canto mio
e della mia amata gente,
per la quale vittorioso
io esco e a cui poscia
spetta il più grande onore,
Altezza, mi felicito
per queste parole che con bontà
tu mi dici, per quanto nemico,
in un'ora della mia esistenza
che sarà indimenticabile.
I desideri e le condizioni
ora ascolta. Accettali, se lo vorrai
e, se vorrai, ratificali,
per averne soddisfazione entrambe le parti;
in caso diverso tieni in mente

se nuk ipemi të gjāllë
e se t' vdesim dim për namin,
tuke marrë uhān e duhurë.
Digjo prān: Të gjithë ushtārët,
pa shtrëngim e pa ndalime,
do të dalin prej qytetit,
tuke pasur pushk e cule,
me llumbardha e me shatore,
e me rraqet çë për rrugë
munt t' i duhen, e mê t' gjitha
çë të zotët ata janë,
sā t' i barin bashk me vehten
do mbi kueljë e do me qerre.
Munt t'u bênet shok atyre
dhe ngā njerëzit e vêndit
kush të dojë, i math a i vogël,
qoft ai në punë t' Mbretit,
a mos qoft. Ata çë mbeten,
myslimanë e të krështerë
nuk do t' gjējën kūrr të keqe
te shëndeti a se te petku,
te të drejtat e te fēja,
në lirī të shpyrtit t' tyre,
as mê pak n' atê të kurmit:
ndonse ata qëndruan si burra
kundra t' huajit tue luftuar
për të mprojtur dhēun e vet
pas mësimit e dëtyrës.
Mosnjerī mos past guximin
në besim t' u siellnjë dhunë,
as te doket, as te veset,
as te gjuha ç' ata flasin.
Ka me u dhênë prān të falur,
me harresë edhe të plotë

ε 39 lumbarda AB cfr. X 60. 56 ndonse sic AB = sepse «se è vero che» data la verità incontrovertibile che gli uomini hanno combattuto per la patria.

che non ci arrendiamo vivi,
e che sappiamo morire per l'onore,
prendendoci il giusto compenso.
Ascolta dunque: Tutti i soldati,
senza pressione e senza ostacoli
usciranno dalla città
con armi e bagaglio,
coi cannoni e con le tende
e con le masserizie di cui potranno per via
aver bisogno, e con tutto ciò
di cui padroni essi sono,
per portarlo con sé
o sui cavalli o sui carri.
Potranno associarsi
a loro anche dei cittadini,
chi lo voglia, grande o piccolo,
sia esso suddito del re
o non lo sia. Quelli che rimangono,
musulmani e cristiani,
non avranno mai alcun danno
nella salute o negli averi,
nei diritti e nella fede,
con libertà della loro anima
non meno che di quella del corpo;
poiché essi resistettero da valorosi,
combattendo contro lo straniero,
per difendere la loro Patria,
giusta l'insegnamento del dovere.
Nessuno abbia l'ardire
di recare oltraggio nella fede,
né nella morale, né nelle abitudini
né nella lingua che essi parlano.
Si darà poi condono,
con amnistia assoluta,

gjithë atyre çë nën urdhër
tuke qênë t' Malit t' zī,
shpīt i lanë, edhe në Shkodrë
për shpëtim të sāj u mlodhën
e përanë nësh te luftat
nuk u ndājtin kūrr njê herë.
Qofshin, n' funt, te hieja e Zotit
e te besa e njerëzīs
të sëmūrë e të varruamë,
e t' u kihet gjith kujdesi
ngjer çë t' aftë ata të jën
për t' u çuar në vênt të vet,
a te ku u pëlqeft mê mirë".
Thash e prenci ndējti dorën
e u përgjegj: – "Ashtu si thua
qoft edhe përpara qiellit
edhe n' êmbër të tim eti,
û Danili i Malit t' zī
bē të bênj për kokën time,
se pas fjalës s' madhëruashme
çë ti fole, e lidhëm besën!"
S' dī përse si zhurma e grenxīt
zêri i tīj në vesh më binte,
edhe keq më prishte zêmbrën.
Po kush ish, kush ishte acāri
çë lëkundej tue më fole
si përpara hies se vetë?
Unë e ruaja n' psherëtimë:
O këshill i thellë i Zotit!
Kūr pa bes' shtërgata e dekës
prap mbi Shkodrën u plandos,
e si shkakun i mahnitur
û kërkoja, Plamenaci
gagalisej e me t' kêndur
përsërinte: – "Edhe njê herë!..."

ε 82 ëmber A. 95 besë AB

a tutti coloro che, sudditi
essendo del Montenegro,
lasciarono le case e a Scutari
per la sua liberazione si raccolsero
e dal fianco nostro nelle battaglie
non si staccarono mai.
Siano in fine sotto la protezione di Dio
e nella fede dell'umanità,
ammalati e feriti,
e che si abbia di loro ogni cura
finché essi siano in grado
di essere avviati nelle loro terre
od ove meglio ad essi piaccia".
Dissi e il principe stese la mano
e rispose: – "Come tu dici
sia anche davanti al Cielo,
e in nome di mio padre,
io Danilo del Montenegro,
ti giuro per la mia testa,
che dopo le parole elevate
che hai pronunziato, la parola è data".
Non so perché come il ronzio del calabrone
la sua voce mi giungeva all'orecchio
e malamente mi turbava il cuore.
Chi era, chi era mai lo zerbinotto
che si dondolava parlandomi,
come davanti alla propria ombra?
Io lo guardavo sospirando:
"O profondo consiglio di Dio!"
Quando la tempesta della morte
di nuovo piombò sopra Scutari
e mentre il pretesto, stupito,
io cercavo, Plamenàz
rideva gongolante e allegro
ripeteva: – "Ci siamo ancora una volta!..."»

XII

Kështu fliste Esad Toptani:
– «Çë te dita kūr sundimin
të qytetit unë e mora,
sosi e Turkut zotërīa,
ndonse edhe me ushtārë t' tij
Malit t' zī në ballë i ndênja,
sā t' i ruaja vêndit t' vjetër
njê ngā pjesët' më gjallnōre,
mê të duhurën gjymtyrë,
zbukurimin mê t' çëmuashëm.
Turqë ata njëment nuk ishën,
tuke i pasur u nën urdhër,
û Shqiptār e gjak Shqiptāri
bashk mê ata të farës tênë,
lule t' farës me t' vërtetë,
çë te fushat e te kodrat
e te malet ku luftonej
më harliseshin për ditë,
e për ditë ata po mirrënin
ngjyrë t' rē e mê t' madhe hie.
Kush e dī ngā t' cilat xhehe
nxuarën hekurin e mirë
ç' u bê shpatë e Skanderbegut ?
Mos qe vall anadollak
i lëvdoshmi trim i jynë
se e kish shpatën damaskine ?
A prej Napulit mos dolli
përse rregji i sāj krahinë
i dha ndihmë mê sā pati
e me burra edhe, çë vdiqën
për shëndet të Shqipërīs ?
Sā prān ishën ata Turqë
para trimavet të Dibrës

e Piana dei Greci, 21 agosto 1916 XII Da questo canto in poi il Poeta trascurò di dare il titolo ai canti. <Këthimi n' vise t' vetë> 18 haliseshin B

XII

Così parlava Esad Toptani:
– «Dal giorno in cui il governo
assunsi della città
finì la sovranità del Turco,
malgrado che anche con i suoi soldati
combattessi il Montenegro,
per conservare alla Patria antica
una delle parti più vitali,
il ganglio più necessario,
l'abbellimento più prezioso.
In quel momento essi non erano Turchi
perché li avevo io sotto il mio comando:
io, Albanese e sangue di Albanese,
insieme a quelli della nostra razza,
fiore di razza veramente,
che nei campi e sulle colline
e sui monti ove combattevasi,
deperivano di giorno in giorno,
ma che di giorno in giorno assumevano
colori nuovi e un più grande decoro.
Chi sa da quali miniere
estrassero il ferro
che divenne spada di Skanderbeg?
Che per caso era asiatico
il glorioso nostro eroe
solo perché avea la spada damascena ?
O che avesse origine da Napoli
solo perché il re di quella regione
gli diede aiuto, più di quanto ne avesse avuto,
e gli offrì anche uomini, che morirono
per la salvezza dell'Albania?
Quanti erano poi quei Turchi
di fronte agli eroi di Dibra,

e të Krûjës e t' Tyranës,
të Kavajës e t' Shêṇ Jakut,
të Peqinit, t' Elbasanit
e t' rrethinavet e tyre?
Mẽ të shumët kishën rênë
trimërisht edhe si flījë,
po si fat i ndājti i Larti
në shpërblim për të keqīat
çë na bêri armiku i moçëm;
edhe ata çë tepërojën
ishën pakë e si të bjerrë
midis nësh. Andaj s'ish Turku
çë ngā Shkodra dilte i fikur
e i ndeshkuam ngā i madhi Zot
kūr te ajo mjesditë e murrëtë
mpronjetōrët zêjën udhën
e këthimit n' vise t' vetë;
por ish shpȳrti i Shqipërīs
pa i përulshëm, i pamundur
çë për pak andej na hiqej
edhe mblidhej te burimi,
për me marrë prap vrullīn,
si shqiponja e zeshkë e qiellit,
e mbi t' huajin për me u turrur,
tuke e gjetur jo në Shkodrë,
se n' pjellore fushë t' Kirit
nuk trevon këlyshi i shkinës,
po te strofulli, ku struket
si shterpîri i përvënērshëm,
të t' mallkuarit mal ndër krepe.
Si më t' ngrysur te qyteti
tuba tuba edhe mbështjellas
Malaziasit u lëshuan.
Por ata delmērë t' rjepurë,

δ 45 Andaj]] Andai KT 58 Shkodrë,]] Shkodërë, KT

ε 56 zeshkë A, zëjën B. 66 Malziasit B.

di Kruja e di Tirana,
di Kavaja e di San Giacomo,
di Pechini, di Elbasan
e dei loro territori?
La maggior parte erano caduti
eroicamente e come olocausti,
ma in quanto a destino Iddio li distinse
eleggendoli a riscatto dei danni
che ci arrecò il nemico antico,
e quelli che sopravvissero
erano pochi e come sperduti
in mezzo a noi. Per cui non era il Turco
che usciva da Scutari abbattuto
e punito dal sommo Iddio,
in quel grigio mezzodì
in cui i difensori prendevano la via
del ritorno ai loro paesi;
ma era l'anima dell'Albania
indomita e invitta,
che per poco di là si ritraeva
per raccogliersi nella sua stessa fonte,
per riprendere poi lo slancio
e, come aquila nera del cielo,
per piombare sullo straniero,
ritrovandolo non più a Scutari,
– poiché nella feconda pianura del Kiri
non alligna il cucciolo della slava –,
ma nel covo dove si annida,
come il rettile velenoso,
fra i crepacci del monte maledetto.
Verso sera sulla città,
a frotte a frotte e imbacuccati
i Montenegrini si slanciarono.
Ma quei pastori laceri,

por ata dhijārë të zbathurë,
ata t' egërë e të ndytë,
më njê herë u pān të huajë
e t' urryeshëmë atje brênda,
për të gjithë udonte toka;
i përzënte fryma e vêndit;
nêma e gjakut të pafajshëm
i plakoste. Ditën pas,
me disā të parë e krênjë,
në qyteze u hyp Danili
mbi bishtgjatin kāl të bardhë
ç' i kish vjedhur njī Shqiptāri,
e si zbriti n' derë e m' kêmbë
n' atê shkim jo mê t' ndaluam
mua më pā, më zûri dorën
e më tha: – "T' u ngjatet jeta!"
Ju përgjegja: – "Në si t' djegurë
sŷt e mī për ethe t' duken,
e në t' dukem tash në faqe
shumë i zbēt, nuk do t' mahnitesh,
brênges time tu' i rār mbrapa
te këjo e vraruame herë
kūr m' arrên në vesh si t' lutur
zëri i trimavet të dashurë
çë po lë te bota e zezë
si n' përitë..." E ai: – "T' brêngoset
s' kā të drejt kush bëri dojën
po si e bêre ti përpara
Zotit t' math e s' tërës jetë
çë ti binde... T' e thom unë,
edhe t' thom e fort e dalë,
unë armik i jyti e i farës,
i pa bîndur mê se t' tjerë!

δ 84 Ju‖ J-u KT 90 kūr‖ kur KT 97 çë‖ cë KT 98 edhe‖ edhē KT
ε 88 tue AB 100 par i bindur A, O par B

quei caprai scalzi,
quei selvaggi e sudici
subito si videro stranieri
e affamati là dentro;
tutti li respingeva la terra;
li respingeva l'alito del luogo;
la maledizione del sangue innocente
li colpiva. Il giorno dopo
con molti capi e comandanti
Danilo salì alla fortezza,
montando un bianco cavallo dalla lunga coda,
che aveva rubato ad un Albanese,
e quando, smontato sulla porta
in quel varco non più vietato,
mi vide, mi prese la mano
e mi disse: – "Ti sia lunga la vita!".
Gli risposi: – "Se ardenti
gli occhi miei per febbre ti sembrano,
e se mi vedi ora in volto
molto pallido, non ti stupire
del mio dolore:
in questa ora fatale
mi giunge all'orecchio come preghiera
la voce degli eroi diletti,
che lascio nella terra nera
come in attesa…". E lui:– "Di addolorarsi
non ha diritto chi ha compiuto il dovere
come tu l'hai compiuto avanti
al sommo Iddio e a tutto il mondo,
che tu hai convinto… Te lo dico io,
e te lo dico e forte e piano,
io nemico tuo e della razza,
*indomabile più degli altri!"»

XIII

Kështu foli Esad Toptani,
edhe fjala e lartë e tij
si të gjithëve veshtrimin
ashtu kapi e lidhi zêmbrat,
sā kūr heshti gjith e ruajën
tuke mbajtur edhe frymën.
Po atê herë mori fjalën
Isa bega Boletini
tuke thênë: – «S' kā të rrebëtë
më se ti, o pasha, e të fortë
vêndi i jynë, e mê t' vërtetë
ti ndër trimat mê t' mëdhenjë,
me qëndrimin tênt u çove
mbi atê majë të ku dielli
i lëvdīs të bardhat rreze
heth e kūrr nuk perëndon.
Prān û thom se t' ruajti Zoti
për këtë të lume ditë
të gëzimit të pamatur
più d'ogni ricchezza desiderabili,
sono più dolci del miele
che stilla dai favi ».

XXVIII

Kështu foli Baba Aliu:
– «E Davidit fryma e lartë
fjalës tênde i shton rrëmbimin
e fuqin, o bīr i dashur;
sā tue thekur ajo zêmbrën
edhe mênden ngreh përpjet
ndëpër fusha të t' pasosmit.
Ashtu edhe kūr e mëngjezit
era e kêndëshme mbi tokën
fluturon, tue tretur shirën,
ngā të lēmit sŷt këthehen
të të gjāllëvet t' mahniturë
për me pār lëvdīn e diellit,
se po çohen mbi kallîrin,
dritës s' tīj të ḥeshmet lule,
çë për akullin e natës,
të përmledhura edhe pezull
kishën kupërat e tŷre.
Tash të thom, e ti besomë,
se, tue folë sot më tŷj,
xûra shumë, e njê t' vërtetë
mbi të tjera: se mê leht
êsht të thuhet *nuk* se *po*
kūr mbi t' qênët përtej gropës
rrahet çështëja e vështirë;
përse vetëm e të marrit
pas të pāmes êsht mohimi;
ndërsā duhet mênde e fortë,
e njê dīje shumë e rrāllë
për të pasur besën tênde;
a njê zêmbërë e dëlīrë,
si e të mirës plakarushe,
a po e djalit pa të keq,

ε Napoli, 10 aprile 1917 <Ligja e shpërblimit >

XXVIII

Così parlò il Baba Alì:
– «La sublime ispirazione di David
al tuo detto accresce l'impeto
e la forza, o caro figlio,
sì che esso, toccando il cuore,
anche la mente solleva
nei campi dell'infinito.
Così allorché del mattino
il vento soave in tutta la terra
alita diradando la tenebra,
verso l'oriente rivolgonsi gli occhi
dei viventi, pieni di meraviglia,
per ammirare la gloria del sole;
mentre rizzansi in sullo stelo,
al suo fulgore, i fiori gentili
che, per il gelo della notte,
chiusi e penduli
aveano i loro calici.
Or ti dico, e tu prestami fede,
che, parlando oggi teco,
molto ho appreso, ed una verità
specialmente: che più facile
è dire no anzi che sì,
quando dell'esistenza d'oltre tomba
trattasi la grave questione;
poiché solo dello stolto
è proprio il negare di aver veduto
laddove richiedesi un forte intelletto
ed una scienza non comune
per avere la tua fede;
ovvero un cuore semplice
come quello della buona vecchietta,
e del fanciullo ingenuo,

çë mësimit i përkulen.
Por tashti mos të të duket
se më bînde më një herë.
Unë jam si lisi i vjetër,
ndonse krejt edhe s' u thajta.
Po te drûri i vdekës vetëm
nuk e bën shpëresa çerdhen,
përse më të prerën degë
nuk e heth ai për jetë!
Po ta dish se s' rā ndër gjêmbat,
as mbi rrugën, as mbi gūrin
fara e lart e fjalës tënde.
Ndo një koqe, nuk e fsheh,
vate n' grykë të zogut t' erës.
Dêm i vogël, çë, pas meje,
vet e deshe, se ti vet
në shkim mbete të t' përtejshmit
i ndërdyshëm, tue vërrejtur
ndë për mjegullë në pafshe
ndo një hīe çë të kēt mênt
e të duket sŷvet tatë
si kūj kā barat ndër tjerë,
tuke thênë: – "Û jam akcili
e të vinj prej tjatrës jetë
si kasnec i të vërtetës".
Po rrī kot tuke përitur,
e do t' rrīsh edhe mê shumë
gjër çë ti, me ditë e vjetë,
sā mê plak me aqê mê dikë,
do të shkosh ta xêsh prej vedit.
Ti më preke në vênt t' pa ruar
kūr, ashtu si dî ti vetëm,
mua më fole gjat e gjêrë
për mbi ligjën e shpërblimit
pas të sjellit; se për vetët,

δ 43 ta‖ t'a KT 63 ta‖ t'a KT

i quali inchinansi all'insegnamento.
Ma non credere adesso
d'avermi convinto in una volta!
Io sono come la quercia antica,
sebbene del tutto non mi sia disseccato.
Ma solo nell'albero della morte
la speranza non fa il suo nido,
poiché esso il ramo che è stato già tagliato
non emette mai più per sempre!
Ma sappi che non è caduto fra le spine,
né sulla via, né sulla pietra,
il nobile seme della tua parola.
Qualche granello, non lo nascondo,
è andato in bocca all'uccello dell'aria.
Danno piccolo, che, a parer mio,
tu stesso hai voluto, poiché tu stesso
ti fermi al limitare dell'al di là
dubbioso, attentamente guardando
fra la nuvole, se mai non veda
qualche ombra intelligente
che si mostri agli occhi tuoi,
come a chi ha privilegio infra gli altri,
dicendo: – "Io sono il tale
e vengo a te dall'altro mondo
come nunzio della verità".
Ma indarno te ne stai in attesa,
e così starai ancor più,
finché tu carico di giorni e di anni,
quanto più vecchio tanto più desideroso,
trapasserai per apprenderlo personalmente.
Tu mi hai colpito in parte indifesa
quando, nel modo che sai tu solo,
mi hai parlato a lungo
sulla legge della ricompensa
a seconda della condotta; ché per gli individui

tue mos pasur jeta fare
lumërī, të drejt e t' vjeft,
në kish t' ish pa shpagë e mira
edhe e liga pa ndëshkim,
kish më qênë gjithësīa
mund i kot i t' shkretes lêndë,
n' dita n' dita i përtërîjtur
e i shumuam me të pa sosur
n' atê luzmë t' mjerë vetësh
tek e cila ajo dërmohet.
Po në shpȳrti, pas të ndâmes
gjēn ngā Zoti atê çë vehtes
përgatiti me të sjellët
tek e para jetë e vetë,
për gjith-monë ashtu tue qênë
krejt i lum, a krejt i zī,
cili mall, a cila dojë
e thërret ndër nē pameta
të shpëtonjë edhe për pak
fatit t' tîj të mirë a t' keq,
kundra fjalës ç' i qe thênë?
Njê përrallë shumë e vjetërë
êsht të dukurit e atyre
çë kaluan të zeshkën valë
e çë pîn të ftohtit ujë
të harrimit të pasosëm.
Prap edhe të thom se n' êndërrë
dëshirimi i jynë i forti
varrin hap e se atê herë
shohim na më sŷ të mbyllurë,
do me thênë me shëllimin
çë prej dhimës êsht i nxitur».

δ 83 gjith-monë ‖ gjith monë KT

non avendo affatto questa vita
felicità, giustizia ed utile,
se dovesse rimanere senza premio il bene
ed il male senza castigo,
sarebbe l'universo
un tormento vano della materia
ogni giorno rinnovantesi
e moltiplicantesi all'infinito,
in quella misera folla di individui
nei quali essa si fraziona.
Ma se l'anima, dopo la divisione,
riceve da Dio ciò che a se stessa
essa preparò con la condotta
nella sua prima vita,
essendo così in eterno
del tutto beata o del tutto infelice,
quale passione o quale dovere
la richiama fra noi,
affinché sfugga anche per poco
al proprio destino buono o cattivo,
contro la sentenza pronunziata?
Una favola antichissima
è l'apparizione di coloro
che attraversarono già la bruna onda
e che bevettero la fredda acqua
dell'eterno oblio.
Io ti ripeto che in sogno
il nostro forte desiderio
apre il sepolcro e che allora
noi vediamo ad occhi chiusi,
vuol dire con la fantasia
eccitata dal dolore».

XXIX

Kështu Mili ju përgjeq:
– «Kē të drejt, o i miri Babë,
se të vjetërit të gjithë
besë i xênin të përhīmit.
Shtonj edhe se ngjēr më sot
nuk kuxojën dot të shumët
t' i rrīn m' ballë gojëdhênës
çë prafton, e çë, pa tjatër,
do të mirrej si e vërtetë,
në e verteta disā herë,
për të zī, nuk ishte e njohurë
prej të pakëve ndër tubë
si të bjerrë. Edhe të pakë
janë ata çë munt të thonë,
pa ndyshim e pa u gënjyer,
se te qielli edhe te bota
kā më gjêra se sā duken,
e se sā kujton i dishmi,
e se sā te nata e tīj
i padishmi po sheh n' êndërrë!
Prān mos thuaj se s' kā njerëzë
çë po pān me sŷt e vetë,
a se t' marrë sŷt i kishën,
a po trût të turbulluame,
prej të nxehtit māll, ç' e shuma
kā si edhe gjithmonë e pati,
në përralla të mbirēshme,
kūr atyre u duk se shihnin.
Burra kā me ndër e zê
te të katra anë t' botës,
çë munt bêjën bē për kokën,
se e vërteta disā herë

δ 1 ju ‖ j-u KT 16 qielli‖ kjelli KT 19 tīj‖ tij KT

ε Napoli, 17 aprile 1917 <Besa të përhimit>

XXIX

Così Milo gli rispose:
– «Tu hai ragione, o buon padre,
nel riconoscere che tutti gli antichi
credevano alle apparizioni.
Aggiungo che fino ad oggi
non osano affatto i molti
contrastare alla tradizione
ininterrotta e che senz'altro
è da ritenersi quale verità,
se la verità, assai spesso,
per disgrazia, non fosse conosciuta
da pochi, che stanno in mezzo alla folla
come perduti. E pochi
sono quelli che trovansi in grado di dire,
senz'alcun dubbio e senza tema di errare,
che nel cielo ed in terra
ci sono più cose di quelle che si vedano,
e di quelle che suppone il sapiente,
o di quelle che nella sua notte
l'ignorante vede in sogno!
Non affermare quindi che non vi siano persone
le quali abbiano visto coi propri occhi,
o che negli occhi costoro avessero le traveggole,
o che avessero il cervello sconvolto
dall'ardente amore che la maggioranza
ha, come sempre lo ebbe
per le favole soprannaturali,
allorché essi credettero di vedere.
Ci sono degli uomini di onore e gran nome
sui quattro lati della terra,
che ben possono giurare per la propria testa
che la verità non di rado

s' i gjet fare të vërtetës,
a po asāj si sot e dīm,
a si t' shumët e kujtojën,
e se besë edhe disāve
nuk i xêm përse, pas dījes,
ç' êsht të njohur të përtashëm,
po na bêhet me të parën,
se t' pamûjtëshme ato janë.
Po pushteti çë natyrës
i dha Zoti, s' kā të sosur;
ashtu prā me të këqyrur
me kujdes e pa të lodhët,
na kallzonen të vërteta,
edhe ato çë thomi bîndë,
çë buruan ngā trû t' sëmurta,
e jasht ligjëvet t' asāj,
përse na ato ligjë t' gjitha
nuk i njohim e, te e shuma,
nuk na bien edhe në mênt.
Pa e përitur pas kërkimit,
na përhapen plasë të rēja
për me ngulur sŷt mê brênda
në të dêndur gjî të rēs
çë po kemi rreth e rrotull,
sā na pret si fare t' pāmit,
edhe bêhemi mê t' urtë
atê herë e mê të pruajturë
përse, e thom me fjalën tênde,
se e të marrit isht mohesa,
po sā u pā me sŷt e vetë.
Po kā tjatër. Û mê para
dua të t' thom se shtete t' shpŷrtit
janë shpaga edhe mundimi
pas të ndārit t' tīj ngā kurmi,

δ 44 kujdes‖ kujdhes KT

ε 43 kërkjurur B.

non è simile alla verità,
ossia a quella che noi conosciamo,
o quale i più se la figurano,
e che fede a molte cose
non prestiamo, perché, secondo la scienza,
che è cognizione attuale,
ci sembra, a prima vista,
che esse siano impossibili.
Ma la potenza che alla natura
diede Iddio, non ha limiti;
così mediante un esame assiduo,
accurato e costante,
quali realtà ci si rivelano
anche quelle che diciamo meraviglie,
scaturite da cervelli insani,
contrarie alle leggi di quella,
solo perché noi tali leggi tutte
non le conosciamo ed in gran parte
non le immaginiamo nemmeno.
D'improvviso, dopo l'esperienza,
ci si aprono dinanzi dei nuovi spiragli,
da poter ficcare gli occhi più in dentro
nel denso seno della nube,
che da ogni lato ne circonda,
sì che ne impedisce quasi affatto la vista,
e diventiamo più prudenti
allora e più cauti,
poiché, per dirla con le tue parole,
è proprio dello stolto il negare
dopo che si è visto con i propri occhi.
Ma v'ha ben altro. Anzi tutto
vo' dirti che stati dell'anima
sono il premio ed il castigo,
dopo che essa si è divisa dal corpo,

sa, ku do e po shkon, i miri
lumërīn e kā në vehte
të paprēme edhe gjithkundi
as për pak të voglësuarë
se gjithkundi e sheh tên' Zonë
e s' i ndahet kūrr; si i keqi
nuk i ndahet kūrr dêmnimit
çë ju dha për jetë t' jetës,
si u dha gjarpërit t' tmeroshëm
kūj u lith ai me fajin.
Qoft te burgu i mjerësīvet,
si ndër hekure e ndë lidhë;
a po vaft edhe për n' erës
tuke u sjellë, a po mbi tokën,
a në t' brêndëshme t' asāj,
bashk e shpie zjarmin e flakës
çë po e djek e nuk e vret,
ç' e mundon e nuk e shqym.
Përse shpȳrtërat na duken
nuk e dîm; po kūj u pyeti
thanë ata se për me mbushur
njê dërgesë, e fjala e tyre,
êsht të njihet si e besuashme.
Ashtu edhe ngā tjerë vênde
të hapsirës pakufishme,
bashk të hȳjëvet me dritën,
ndër nē derdhen, për të mirë,
rreze t' mêndes të shpërdāme
gjithasājtena, si jeta,
e të t' parëvet pushtete
se ndë shkallë të të qênit,
çë shtëllonet te t' pasosmit,
ndër 'ta shkëmet janë t' lidhurë.

δ 74 ju ‖ j-u KT 96 parëvet ‖ parevet KT

per cui ovunque si trovi, il buono
ha in sé la felicità
intera e completa,
per nulla affatto diminuita,
poiché completa ha la visione di Dio
e non se ne stacca mai; come il malvagio
non si stacca mai dalla condanna
datagli per tutta l'eternità,
come fu data al serpe orrendo
cui legossi per mezzo della colpa.
Sia egli nel carcere delle miserie,
come fra catene ed in ceppi;
ovvero se ne vada per l'aria
aggirandosi, o sulla terra,
o nelle viscere di essa,
insieme ei porta l'ardore della fiamma
che lo brucia e non lo uccide,
che lo tormenta e non lo distrugge.
Perché le anime ci appariscano
ignoriamo; ma a chi ebbe ad interrogarle
esse risposero che per adempiere
ad una missione; e la loro risposta
è da ritenersi come credibile.
Così pure da altri luoghi
dello spazio immenso,
insieme alla luce degli astri,
in mezzo a noi si versano a nostro vantaggio
raggi dell'intelligenza diffusa
da per tutto, come la vita,
e delle potenze supreme,
poiché nella scala dell'essere,
che si spinge nell'infinito,
i gradi sono in rapporto fra loro.

XXX

Nën ullînjëvet te ḥeja
ishte shtruar e gūrta tryesë
me të bardhin lî si bora,
me puçerë e qelqe t' thjelletë
te ku qeste shkumë t' kuqe
vera e vjetrë e Bregut t' Dētit.
Ndër 'ta njerëzë të mirë
e në vênt aqê të būkur
njê gëzim i math e i ndërshëm
mbretëronte; e si edhe qielli
pa njê rēzë, e si pasqyra
e atīj uji fortë të kaltër,
ç' atje ndênej para sŷvet,
pa njê rrudhë; ashtu të gjithëve
në të prêrët ishën zêmbrat
edhe shpȳrtërat në paqe.
U ngre shtuara Gurakuqi
e me māll tue ruajtur Milin,
ndër të heshtur erdhi e nisi:
– «Sot për gas këtu të mledhurë
ngā gjithë anët t' vêndit tênë
na të thomi me njê fjalë,
ç' êsht dëftesa e njī mendimi,
se ndër në me kêmbë t' bardhë
erdhe ti te hera e mirë.
Si hylvēri ngushëllonjës
çë n' hapsirët shkruajti Zoti
sā të dukej pas duhīs
si kujtim për mot e jetë
i asāj bēje të hierushme
ç' i bê burrit të pafaj,

δ 4 thjellëtë‖ thiellëtë KT 7 'ta‖ ta KT 9 ndërshëm ‖ ndëshëm KT 10 qielli ‖ kjelli KT

ε Napoli, 26 aprile 1917 Prenk Bib Doda" > <Pjesa e tretë — Prenk Bib Doda "Cantica terza — <Dolli>

XXX

All'ombra degli ulivi
era apparecchiata la tavola di pietra,
col lino bianco come neve,
con stoviglie e bicchieri tersi,
in cui sprizzava, spuma rossa,
il vecchio vino della sponda del mare.
Tra queste ottime persone,
e in luogo così bello,
una gioia grande ed onesta
regnava; e come il cielo
senza una nube e come lo specchio
di quell'acqua molto azzurra
che si estendeva avanti agli occhi
senza corrente, così di tutti
in tranquillità erano i cuori
e le anime in pace.
Sorse in piedi Gurakuqi
e con affetto riguardando Milo,
nel silenzio cominciò a dire:
– «Oggi per gioia qui riuniti
da tutte le parti della nostra Patria,
noi ti diciamo con una parola,
che è la manifestazione di un comune pensiero,
che tra noi bene atteso
sei venuto nell'ora buona.
Come l'arcobaleno consolatore,
che nello spazio dipinse Iddio
perché apparisse dopo la tempesta
per ricordo eterno
di quel patto divino
che fece con l'uomo innocente,

kūr e nxori vet jasht ujit,
si njê rrênjë të shëndoshtë
njerëzīje për t' u rijtur;
ashtu na n' agim të ditës
të lirīs çë dëshiruam
kemi tyj, se ashtu prej teje
sigurī na del e rrjeth
për atê çë kā për t' ardhur
kohë t' lume t' Shqipërīs,
si prej teje n' mes të natës
po na dolli e rrodhi e bukurë
edhe rrezeja e shpëresës.
Û në vênt t' atyre djelmë
çë mê kêngat tote u rritën,
mê se t' mêmavet me dhelkat,
po si zogjët e shqiponjës
me ulurima të stuhīvet;
û në vênt t' atyre djelmë
çë me zêrin tênt te veshi
ndenjën qut me ballë t' vrêrët
kundra natës e me dorë
po në mbrû të pallës s' mprehtë;
û në vênt t' atyre pleqë
çë qëndruan më të përitur
ngjër më sot e nuk u lodhën
për të lartën fjalë tênde,
a të cilët tash munt t' shkojën
pas të luturit e tyre,
se mê sŷ ngā varri i moçëm
pān të vdekurën të ngjāllej;
këtë verë t' fjeshtë e pî
për shëndetin tênt, o i dashur,
e të thom: "Po rrofsh e qofshe!"
U pëlqye këta të folë
ngā të gjithë, e si tri herë

δ 37 tŷj ‖ tyi KT 60 sŷ‖ s^ KT

quando lo trasse dalle acque
come radice sana
di una umanità da rinnovarsi,
così noi, all'alba del giorno
della libertà che desiderammo,
abbiamo te. Così per tuo mezzo
ci proviene garanzia
per quella che verrà
ora felice dell'Albania,
come per tuo mezzo nel cuor della notte
ci apparve e giunse a noi sempre bello
anche il raggio della speranza.
Io in nome di quei giovani
che crebbero al ritmo dei tuoi canti
più che con le materne carezze,
– come i nati delle aquile
al fragore degli uragani –
io in nome di quei giovani
che con la tua voce all'orecchio
stettero in veglia con fronte arcigna
rivolta contro la notte e con la mano
sempre sull'elsa dell'affilata spada;
io in nome di quei vecchi
che stettero aspettando
fino ad oggi e non si stancarono
per virtù della tua elevata parola,
e che ora possono ben morire,
giuste le loro aspirazioni,
poiché con i loro occhi dall'antico sepolcro
videro la morta risorgere;
questo vino schietto io lo bevo
per la tua salute, o caro,
e ti dico: "Che tu viva e viva a lungo!"
Piacquero tali detti
a tutti, e dopo che tre volte

me njê zê bërtitën: "rrofsë!"
zbrazën qelqet për së bashku
e, pas dokës, bashk i hodhën
me rrëmbim të math te dhëu
tuke thênë: – «U theft e liga!»
Me të hieshmit sŷ ndër lotë
ngā të thekurit e zêmbrës
çë prej kêndës s' parrëfyeshme
të të lartit ndër buronte,
u përgjeq atyre Mili,
e si fliste i dridhej zêri:
– «Shpaga e punës çë ju, vllezërë,
mua më falni sot, e n' êmbër
të së tërës gjînde tênë,
êsht ajo çë dëshirova
ndër të huaj e ditë e natë,
kūr u luta me të nxehtë:
– "Epe, o Zot, të kën të vjejtur
e t' mos dalin kūr të kotë
këta munde çë po shtonen,
tue më thār te mosha e lume
e m' i dīshin për të mirë,
kūr t' i zbardhet ora e tyre,
fare e fise t' vêndit t' vjetër;
jo për grat të vehtes time,
po për hīrin e asāj gjinde
të t' lëvdoshmit dhē ku u leva,
e te ku si jam u bêra
edhe u rrita Shqipërīs
pas të t' parëvet dëshirit"».
Tha e të gjith i miratosën
këto fjalë shumë t' larta,
sā edhe klithën: – «Drita u shtoftë
hŷllit t' bardhë t' Italīs!»

δ 67 bërtitën: ‖ bërtetën KT 96 dëshirit ‖ dhëshirit KT

ad una voce gridarono: «Viva!»
vuotarono tutti insieme i bicchieri,
e, giusta il costume, li lanciarono
con veemenza al suolo
esclamando: «Perisca il male!»
Con i vaghi occhi in lacrime,
per la commozione dell'animo
che per la gioia inenarrabile
di tanto onore sgorgava,
rispose a loro Milo,
e parlando tremavagli la voce:
– «La ricompensa dell'opera di cui voi, o fratelli,
mi siete generosi, e in nome
dell'intera nostra gente,
è proprio quella che io bramai
fra gli estranei e giorno e notte,
quando ardentemente pregai:
– "Concedi, o Signore, che riescano utili
e che mai siano vane
queste fatiche che sempre aumentano,
struggendomi nell'età felice,
e me ne sappiano grado,
quando a loro sorriderà l'ora propizia,
stirpi e famiglie dell'antica Patria,
non per vantaggio della mia persona,
ma per gratitudine verso quel popolo
della terra gloriosa ove io son nato,
e dove qual sono io divenni
e sono stato allevato all'Albania,
giusta le aspirazioni dei miei antenati».
Disse e tutti approvarono
queste nobilissime parole,
per cui tutti esclamarono: – «Si accresca la luce
alla bianca stella d'Italia!».

XXXI

I përitur ngā të gjithë
me gëzim edhe me ndër,
te ato ditë arrû prej Rromës
Prênk Bib Doda, dritë e gjallë
e Mirditës, edhe e të têrit
Dukagjin. N' atê qytet
t' amëshuam e të paprekshëm
gjê si cilin mê të madhe
prej së larti dielli n' udhë
nuk pā kūrr mbi t' gjêrën tokë,
kishte shkuar ai mê parë
se t' këthehej prap ndë vonë,
si petrit i Malit Shêjt,
në t' lëvdoshmen çerdhe t' vetë;
përse desh atje në krûa
të lirīs e të të drejtes
mê dëfryer edhe marrë
do fuqī për punë t' rēja
mê t' veshtira e prān se tjerat
mê t' mëdhā. Njê zet' e pesë
vjetë ai në dhe të huaj
vuajti tepër pa njê fjalë,
e ngā ata kaloi të shumët
po te strofulli i Kulshedrës
ngāha n' funt u holq për bîndë,
si ngā shpella e Bilibamës
mentëholli Udhusht i vjetër,
pas çë pā mê t' mirët shokë
gjellë t' keqe të përbîmës.
Atje brênda mê pabesë
kishte rênë djali i rī
prej guximit t' zêmbrës s' madhe
e prej shpȳrtit t' lart shqiptari,

ε Napoli, 26 maggio 1917 < Prenk Bib Doda >

XXXI

Da tutti atteso
con gioia e con onore
in quei giorni giunse da Roma
Prenk Bib Doda, vivida luce
della Mirdizia e dell'intero
territorio del Ducagino. In quella città
eterna ed intangibile,
di cui cosa più grande
dall'alto il sole nel suo cammino
mai vide sulla vasta terra,
egli era passato prima
di ritornare ancora indietro,
come sparviero del Monte Santo,
nell'onorato suo nido;
poiché volle là, alla fonte
della libertà e del diritto,
ricrearsi e riprendere
vigore per nuove fatiche,
più ardue e delle altre
più importanti. Ben venticinque
anni in terra straniera
sofferse troppo senza un lamento,
e di essi passò la maggior parte
nel covo della Kulshedra
da cui infine si sottrasse per convincimento,
come dalla caverna di Polifemo
l'astuto antico Ulisse,
allorché vide i migliori compagni
divenire orrido pasto del mostro.
Colà dentro proditoriamente
era cascato il giovinetto,
per l'ardimento del gran cuore
e per l'animo elevato di albanese,

kūr të vêndit për shëndetin
u betuan ndër 'ta fatosat
ngā gjith anët, edhe botën
e mahnitën me të lartat
punë t' tyre. Oh të lëvdoshme
ditë ato për t' u kujtuar,
kūr u duk me të vërtetë
se një gjak edhe një besë,
po si i pati, i kā përherë
fort e rrepta gjînde e jonë,
çë ngā e plira Rrashë e verit,
ngjër në Lartë e në Prevezë;
çë ngā dēti i perëndimit
ngjër te t' bardhët krepe t' Pindit,
e te fushat e Vardārit!
Grekë e Shqē, në vênt të Turkut,
me fuqī e pëlqim të tjerësh,
i përlytin viset tona.
Po ngā fati i keq u rrējtin
edhe shpejt i gjeti e liga,
se prej gjakut të pafajshëm
grāsh e pleqësh e fëmījësh
u mbush kupa hidhërimit
më një herë. Ashtu mbi vehten
ata vetë e deshën zjarmin
ndërsā Turku çë s' kā shpȳrt
dolli i but përpara atyre,
dhe kūr thērti e dogji Armenë.
Po nuk mbyllet dot faliku
ngjër ç' ata një qint për një
nuk paguajën për me u lām.
Si kush dī se s' munt të gjënjë
përdëlim te jeta e vetë
as ngā njerëzë, as ngā qielli,

δ 45 ngjër]] ngjer KT 50 fuqi]] fukji KT 66 përdëlim]] përdëllim KT 67 qielli,]] kjelli KT

ε 35 labuan B.

quando per la salute della Patria
giurarono tra loro gli eroi
da ogni parte e la terra
fecero sbalordire con le magnifiche
loro gesta. Oh beati
giorni degni di memoria,
quando sembrò in realtà
che un sangue ed una fede,
come li ebbe, li ha per sempre
l'arditissima nostra gente,
dalla insanguinata Rasba del settentrione,
fino ad Arta e a Prevesa,
dal mare di occidente
fino ai bianchi picchi del Pindo,
e alle pianure del Vardar!
Greci e Slavi, al posto del Turco,
con aiuti e consenso di altri
contaminarono le nostre terre.
Ma dalla sfortuna furono smentiti
e subito li colse il loro danno,
che per il sangue innocente
di donne, di vecchi e di bambini
fu colma la coppa della collera
rapidamente. Così su se stessi
essi vollero il fuoco,
mentre il Turco spietato
sembrò mansueto avanti a loro,
anche quando scannò e bruciò gli Armeni.
Ma non si chiude affatto la partita
finché essi cento per uno
non pagheranno per purificarsi.
Come colui che sa di non poter trovare
misericordia nella propria esistenza
né dagli uomini, né dal cielo,

rrī Sinoni, i ngashëruam
tue përitur një shkreptim
për mbi kokën. E pas turpit
çë mê t' lik e mê të poshter
do të qesnjë n' sŷ të botës
edhe prān n' ata të vehtes,
kā të kēt atê ç' i preku
për të zezat e t' meroshme
çë po bêri pā u kursyer
kundra nësh. Ndër 'të si bushtërë
ndëpër hī t' kërsollës s' djegurë
ulurin e ngrata Shkinë
e përplaset e shkul flokët,
çë kā gup e t' shpupurisurë,
edhe ballët vret më grushte,
edhe gjîrin shkyen me thonje,
e gërvisht të zbētën faqe.
Midis gropavet të murrta
i shkëlqejën sŷt si prushi,
ata sŷ t' mëdhenjë e t' egërë
pa mê lotë e pa shpëresë;
çë si tigjërë e trenuame
i këthen e rreth e rrotull
në ndëshkim e në t' kërkuar.
Te ku djelmët kā edhe vashat ?
Ku të rējat e t' dhëndūrrat?
Ku të nipërat e të mbesat?
Gjith u shkunt edhe Margjela
kūr të birin i rrëmbyen;
në përanë i mbeti Dava,
rrezë qielli e njerëzuame,
e te zêmbra i mbeti besa
në shpëtim të trimit t' ndërshëm.

ε 73 kësollës‖ kërsollës KT 93 t'‖ të KT 98 qelli‖ kjelli KT

ε 90 i om. B. 93 t' dhëndūrrat AB. 94 nipërit AB.

sta Sinone, affannato,
aspettando un fulmine
sulla testa. E dopo l'onta
che peggiore e più abietta
lo presenterà davanti al mondo
e ancora avanti a se stesso,
avrà quanto gli spetta
per le nefandezze tremende
che commise senza risparmio
contro di noi. Mentre come cagna
tra la cenere del pagliaio incendiato
urla l'infelice Serbia
e si abbatte e si strappa il crine
sciolto e arruffato,
e coi pugni si batte la fronte,
e il petto squarcia con le unghie,
e graffia la pallida faccia.
Dentro le livide occhiaie
brillano gli occhi come bragia,
quegli occhi enormi e selvaggi,
senza lacrime e senza speranze,
che come tigre spaventata,
balza di qua e di là
in pene e in suppliche.
Dove ha i giovani e le fanciulle?
Ove le nuore e i generi?
Ove i nipoti e le nipoti?
Tutta si agitò Margjela
quando le sottrassero il figlio,
anche se a fianco le rimase Dava,
raggio di sole personificato,
e nel cuore le restò la fede
nella salvezza del giovane egregio.

XXXII

Nuk këthehet i ndërruam.
Fort i ngrehur prej rrëzikut
si me hīr, për vênde t' hûajë
te të parët t' rī të tīj,
u kish nisur ngā Shên Gjini
për dredhī të Dervish Pashës,
të mos dukej fare t' çiltë,
e me gjith se i qante zêmbra,
se të ndênjurit përjashta
shumë t' gjat do t' ishte e t' rêndë,
prap e prap pa rē ndyshimi
Orën ndiqëte e të sŷt
dritën kish të zêmbrës s' madhe
edhe fanë e derës s' tīj.
Prān ashtu në vehte i mledhur,
pa nj' ankim e pa njê fjalë,
por me mênde fare t' prēme
që të dilte faqebardhë,
nuk diftonte as lavdë, as frikë
m' ballë armikut të pashpŷrt
ç' e përiste si n' pusī
për me e mbytur pas dëshīrit
e pas vesevet bishōrë.

α KT, KT1

γ 1 [—Sa i ndërruam ai këthehet \ Nuk këthehet i ndërruam.] 2 [— \ Fort i ngrehur prej rrëzikut] 3 [— \ Si] [— për \ me hīr] [— panjohta \ — më të fshehta\vênde t' hûajë] 4 [— u kish nisur me të\te të parët t'] [—] 5 [— \ Shên Gjini] 7 [— shumë t' çiltë të mos dukej,\ — të mos dukej shumë t' çiltë \ të mos dukej fare t' çiltë,] 8 qante² zêmbra¹ 9 [— se do t'ishte t'gjat të memit \ — \ se të ndênjurit përjashta] 11 [— edhe ndoshta pa ngushëllimim për gjith monë \ — ndoshta edhe pa ngushëllimim \—\ bên të hekurit t' durishëm, \ — prap e prap tue ndjekur farin\ prap e prap, pa rē ndyshimi] 13 kish [—] 16 [— fjalë\ ankim] [— ankim \ fjalë] 17 [— n'udhë nuk vefte shkak armikut\ por me mênde fare t' prēme] 19 [— as frikë, as lavdë \ as lavdë, as frikë]

δ 5 Gjini‖ Gjoni KT

ε Napoli, 12 maggio 1917 <Mërgimi i Prenk Bib Dodës> 5 Gjini, ma d'incerta lettura, A. 18 kjë sic, cfr. invece v. 21 «ç' e».

XXXII

Non ritorna cambiato.
Sospinto alquanto dal pericolo,
con piacere per terre straniere
nei primi suoi anni
era partito da S. Giovanni
per astuzia di Dervish Pascià:
non doveva sembrare affatto manifesto,
e pur gli piangeva il cuore
ché il vivere in terra straniera
molto lungo e pesante sarebbe stato.
Ma fedelmente, senza ombra di esitazione
egli seguiva il fato e negli occhi
aveva il riflesso del gran cuore
e l'orgoglio del suo casato.
Poi così rinchiuso in se stesso
senza un lamento e senza una parola,
con l'animo più che deciso
di uscirne onorato,
non dimostrava né superbia, né paura
di fronte al nemico crudele
che lo attendeva all'agguato,
per soffocarlo, giusta il desiderio
e le abitudini feroci.

Po si gjithë atīj s' i gjān
për të rallën mênde t' hollë
të pashokët trima tanë
ç' u betuan në Prisërênd
do për jetë e do për dekë?
Ndoshta aqê s' do t' kishte ḥekur
Abdil begu i lavduroshëm,
edhe kurmin fare t' çartur,
se të hedhur prej së larti
me pahīr, s' e kishte lênë
n' arë t' zezë t' Kastamunit,
shpȳrti i fort i Hodo begut!
E këtīj të Fusha e Çelës
gjêmon fjala ngjër më sot:
– «Na çë lehemi ngā shokët
e të madhit Skanderbeg,
edhe jemi farë n' botë
ngā mê t' fjeshtat e fisnike;
na pa ndihmë t' mosnjerīu
ndër njê tufë t' nêmur ulqish,
çë të prës po marrin erën;
na, për Zotin!, mirë e dīm
si do t' ruhemi prej nësh
e si varret të nderojëm
të të lertëvet të parë!

γ *24* [— çë gërryku i qet në shesh.] 26 \ të pashokët trima tanë/ *27* |— ç' u betuan në Prisërênd| 27-28 [ç' u betuan në Prisërênd | do për jetë e do për dekë?] *29* për shëndet të dheuthit t' dashur? *31-32* ç'ishte i kohës me t' vërtetë | atdhetari mê i [— \përkryer] 31 |— edhe kurmin n' copa copa,\ edhe kurmin fare t' çartur,] 32 [— se prej të rāmit\ se të hedhur prej] *33* |— për të shtȳm vratōrësh turqish] 34 \ n' arë t' zezë t' Kastamunit,/ 35 |— | fort |] 36 | -- Ngjër *menatnet*\ E këtīj] 37 |— fjala e tīj gjêmon e thotë:\ gjêmon fjala ngjër më sot:] 39 |— të \ të] 40 | — e çë\ᵠ edhe] far[a \ᵠ ë] [-- e fjeshtë\ n' botë] 41 [-- mê fisnike m' e fjeshtë; \ ngā mê t'fjeshtat e fisnike;] 42 [– \ na pa ndihmë t'mosnjerīu] 43 \njê / tuf[a \ë] |— ulqish t'egër \ t'nêmur ulqish] *45-46* |— dim si t' rritemi prej nësh | të kën ndër atrorët varre.] *47* |— të të parëvet] 48 |-- parëvet \ lertëvet]

δ 26 të pashokët trima tanë‖ e për shokët trima<t> KT 30 lëvduroshëm,‖ lavduroshëm, KT 37 ngjër‖ gjër KT 43 tufë‖ tubë KT

ε 32 së.

Ma perché a lui tutti non somigliarono
per l'acuta intelligenza
quei nostri valorosi compagni,
che giurarono in Prisrendi
per la vita e per la morte?
Forse non avrebbe sofferto tanto
il celebrato Abdul beg,
e il corpo affatto distrutto,
come lanciato dall'alto
con violenza, non avrebbe lasciato
nel campo nero di Kastamuni,
l'anima forte di Hodo beg!
Di costui nella pianura di Cela
tuona il detto ancora oggi:
– "Noi che discendiamo dai compagni
del grande Skanderbeg,
e siamo razza in sulla terra
delle più pure e delle più nobili;
noi senza aiuto di alcuno,
fra una torma di lupi maledetti,
che sempre aspirano al bottino;
noi, per Dio! ben sappiamo
come conviene da noi difenderci
e onorare le tombe
dei magnanimi antenati!

Ashtu edhe ngā trûja e Oroshit,
bashk me zhurmën e flamūrit,
çë po lyp uhān e gjakut
t' atīj trimi ç' i la shênjin
ndër dȳ majat ku del dielli,
shpërndān dredha te gjithë anët
të kushtrimit t' rreptën thirmë
edhe zêrin e Gjon Markut
çë bërtet e thot si thoshte:
– "Bini, mêca! Bini, mêca!
Për lirī e shëndet të vêndit!"
Mesandaj në qiell të vrêrët
të Gusinjës t' hidhëruame
oshëtin e thêna, burri
e Ali Pashës të pavdekshëm,
çë të vetë e bẑn të gjithë:
– "Porsa mbreti nuk kā shpȳrt
e si tufa dhīsh e delesh
na dhuron e shet të hōit,
çë nën urdhër edhe patëm,
na, çë sot, te lufta e madhe,
ngjēr çë t' dalim faqebardhë,
çë t' biem me ndēr te varri,
dȳ do t' kemi m' ballë armiqë!"
Gjith kësosh i flakur ndienjash

γ 50 |— \ — njohurën vishkullimë\ zhurmën e flamūrit,| 51 |— të flamurit të përgjakëm\ çë po lyp uhān e gjakut| 52-53 \t'atīj → dielli,/ 55 |— rreptën \ vjetrën\ rreptën| *56-59* | — edhe të njohtën brimë t' luftës: |"Bini, mêca! Bini, mêca! | Për mbi papërmit e ndȳra | vêndit sot, na e patëm thênë| *64-66* | — një me at| o\+a | të |— Abedin \ Jakar| begut | në |— Prevezë \ i Shqypit,|e t' Musta pashës. | Dy do t' kemi |— \ m' ballë| armiqë| 65 | — "Porsa |— \mbreti| m'jep të huajit \ "Porsa mbreti nuk kā shpȳrt| *66* |— e na shet at| 66 | — dhemë e| tufa dhīsh e |— \ delesh| 67 | — e na jep\ na dhuron| 68 \ çë nën urdhër edhe patëm,/ 69 |— e ngjēr \ te lufta| 72 |—\ m' ballë | *73-74* |e si një rezë të mirë, | e si burra të vërtetë!| 73 \Gjith/ |— ndienjash gjith i flakur \ i flakur ndienjash|

δ 54 shpërndān‖ shpërdān KT 61 hidhëruame‖ idhëruame KT 62 thêna,‖ thëna KT 66 tufa‖ tuba KT 67 hōit,‖ huait, KT 68 patëm,‖ patëm; KT 72 m'‖ n' KT

Così anche dalla torre di Orosci,
insieme al garrito della bandiera
che invoca la vendetta del sangue,
di quell'eroe, che lasciò il segno
fra i due picchi ove spunta il sole,
il vento diffonde in tutti i lati
dell'allarmi l'ardita nota
e la voce di Gjon Marco
che grida e dice come nel passato:
– «Colpite, ragazzi! Colpite, ragazzi!
per la libertà e la salvezza della Patria!»
Frattanto sull'orizzonte cupo
della desolata Gussigne
echeggia il detto virile
dell'immortale Ali Pascià,
che parla in nome di tutti:
– «Poiché il re non ha anima
e come branchi di capre e di pecore
ci regala e ci vende allo straniero,
che a noi fu soggetto,
noi, da oggi, nella grande guerra,
finché non ne usciremo vittoriosi
o con onore non cadremo nella tomba,
affronteremo due nemici!»
Di tal fatta ardente di sentimenti

mê̂ se t' tjerë Prêng Bib Doda,
se mê̂ shumë i rī se t' tjerët,
e ngā mêma e fortë i ushqyem,
me të luânit mish e palca
ndênji shtuara para Mbretit,
pa krênī po edhe pa marre,
pak i zbēt, po jo me dridhmë,
ndonse e dînte se mbi kokën
prej njī pêri i virej kordha,
e se shihte n' sŷ t' atīj
atê̂ dritë t' keqe t' bishës
çë kā gjân e dëshiruame
ndër këthetërrat e mprehta.
– «More ti, kapitan Prênga,
të vërtetën të më thuash:
Kush të shtŷti e rroke shpatën
për të shkretën Shqipërī,
mua, t' e ruaje, të shtrënguar
sā t' e dēja me pahīr
copa copa n' dorë armiku ?»
– «Zot i math, t' u ngjatët jeta!
Dashurī të vêndit t' mjērë
mua më shtŷti e shpatën rroka
kundra armikut bashk me shokët;
jo për tīj, të paça uratën!...»
Edhe Mbreti tuke qeshur:
– «*Erbab ulan, pilaf jer!*»

β 85-86 çë → mprehta.] çë kā bisha kūr ndër thonje | gjân e kā të dishiruame. KT1

γ 74 [—\— gjith i ndezurë \ mê̂ se t' tjerë] 76-77 [— e ngā e forta mêmë i ushqyem | po me [— palcat e luânit \ misht e palca luâni] \ e nga mêma e fortë i ushqyem, | me të luânit mish e palca] 79 | — pa \ edhe pa] 82 [— pêri \ -- floku\ pêri] 87 [— Kush të shtŷti \ More ti, kapitan Prênga,] 91 [— t' e ruaja mua \ mua, t' e ruaje, të shtrënguar] 92 [—\ sā t' e dēja me pahīr | 93 | — me të vërtetë\ t' u ngjatët jeta!] 98 [-- \+ paça |

δ 74 se t'tjerë‖ se tjerë KT 75 se t'tjerë‖ se tjerë KT 76 mêma e fortë‖ mëmë e fort KT 77 me të luânit‖ më të luâmit KT 80 dridhmë,‖ dridhëmë, KT 91 mua, t' e ruaje,‖ mua t' e ruaje KT 94 ngjatët‖ ngjatet KT

ε *arbab pilav jer — ärbab ulán pilâv jer* "scaltro tu il pilaf mangi" "scaltro tu hai ragione". *Okelli* (istruito) *okelli* "l'occhiello" KT1

più che gli altri Prenk Bib Doda,
poiché era più giovane degli altri
e alimentato da un'eroica madre,
con la carne e il midollo del leone,
stette ritto avanti al Sovrano,
senza superbia, ma con serietà,
alquanto pallido, ma senza tremore,
benché sapesse che sul suo capo
da un filo pendeva la spada,
e che vedesse nell'occhio di lui
la cattiva luce del serpente
che ha la preda bramata
tra gli artigli acuti.
– «O tu, capitan Prenga,
dimmi pure la verità:
Chi ti spinse a sguainare la spada
per la desolata Albania,
per conservarmela stretta,
perché la lasciassi mio malgrado
fatta a pezzi in mani nemiche ?»
– «O gran Signore, ti sia lunga la vita!
L'amore della misera patria
mi spinse a sguainare la spada
contro il nemico, insieme ai compagni,
non per te, che tu mi benedica!...»
E il Sultano ridendo:
– «Scaltro, tu hai ragione».

XXXIII

Nuk këthehet i ndërruam.
E si mundej kūrr ? Me kohë
gjelbëron dhe mali i thāt,
e shkretohet pa i kujdesur
mê pjellōri vênt i botës;
po i Mirditësit për jetë
njê si fjala ashtu edhe shpȳrti;
ashtu ndienjat si edhe gjaku,
gjaku i mirë e i papërziem,
gjaku i vjetër arbënōr
çë vetvedit, qysh u ndie,
s' i rā mohit ndo njê herë.
Kush e njohu e ndēr s' i fali ?
Kush mê t' math i fali ndērin
e s' u duk përpara vehtes
po si tepër i kursȳeshëm ?
Êsht i drejt ai e besnik
e t' vërtetën çë dî t' hidhëtë
nuk e mbān në zêmbrë t' fshehtë,
por e thot me hie të tillë
sā në t' parë i mpshihet âmti,
dhe këthen aty për 'ty
njê përgjigje çë shiton
fjalës t' ashpërë e t' pamirë;
njê përgjigje çë pret dejët

α KT1

γ 5 | —\ — kopsht\ vênt] 6 [— t' \ i] [— \ për jetë] 7 [— po njê fjala \ njê si fjala| 8 [— \ gjaku | 9 | — \ gjaku] \e/ 10 | — \ arbënōr| 11 [— \ çë vetvedit, qysh u ndie,] 12 | — s' i rā mohit ndo njê herë.\— nuk i rā vetvedit \ s' i rā mohit ndo njê herë.] 13 | — s'i bê ndēr \ ndēr s' i fali ?] 14 [— \ Kush mê t' math i fali ndērin | 15 [— qê t'i shkonte për ditë\ e s' u duk përpara vehtes | 18 [— \ e t'] 21 | — sā më t' hollin më njê herë | nuk e ther i zoti edhe të dhëmbur \ sā në t' parë i mpshihet âmti,| 22 | — \ dhe këthen]

δ 3 thāt,‖ thāt KT 19 në zêmbrë‖ te zêmbra KT

ε Napoli, 23 maggio 1917 <Prenk Bib Doda è Frants Josifi> 23 *una risposta che inchioda* KT1

XXXIII

Non ritorna cambiato.
E come era mai possibile? Col tempo
verdeggia anche l'arido monte,
e si distrugge incoltivato
il più fertile luogo della terra;
ma del Mirdita per sempre
sia la parola che lo spirito sono uno;
così i sentimenti come il sangue,
il sangue buono e non mescolato,
il vecchio sangue albanese,
che se stesso, da quando si conosce,
giammai ha rinnegato.
Chi lo conobbe e non gli rese onore?
Chi avendogli reso il più grande onore
non apparve avanti a se stesso
molto avaro ?
Egli è leale e fedele,
la verità che conosce amara
non mantiene segreta in cuore,
ma la manifesta con aria
che in sulle prime nasconde l'asprezza
e ti controbatte lì per lì
con una risposta che colpisce
e con la parola aspra e sfavorevole;
una risposta che taglia i nervi

edhe lê në bîndë e t' ngelur.
Ashtu qe se kūr në Beçe
i tmeroshmi plak i Abzburgut
Prênk Bib Dodës i tha çiltas:
– «Û të kam armik si t' pata,
sā jē, majde, për t' u prishur!»
Këso fjalësh për me u thênë
ja përiti i rrepti trim:
– «Madhësīs u lumt kurora,
po pushtetin e të drejtes
Zoti e mbaftë edhe mbi kryet
e Shqiptārit të pafajshëm,
si ja mbājti ngjēr më sot!
Çë jam ù përpara teje,
mbret i math edhe pa skaje
në të kryer të dashurimit ?
Po se ç' isha vet i ngrati
para atīj Sulltani t' kuq
çë s' u loth tue vrār? Njëmênt
mua më ruajti Perëndīa
(falë i qofsha!) e të grymosur
pāsh me sŷt Abdul Hamidin,
e Turqīn tue dredhur bishtin!...»
Heshti edhe me ballë t' vrêrët
e vërrēnte Franc Josifi,
po të zênë e kishte gjuhën
prej mërīs. I prori shpinën

γ 32-33 | — |— ju përgjeq| kështu trimi |\— ju përgjeq/ \— aty për aty| | çë jam ù përpara Nemeces \ Këso fjalësh për me u thênë | ja përiti i rrepti trim:| 35 |— \ po pushtetin e të drejtes| 38 |— \si ja| |— \ ngjēr më sot.| 39 |— ndër rrëzique çë nuk njeh\ — çë vall jam përpara teje \ Çë jam ù përpara teje,| 40 | — aqê vjetë ! E çë jam ûnë, | vall çë jam përpara teje\ mbret i math edhe pa skaje | *41* | - – i fuqishëm e pa skaje | 43 | — m' ballë\ para| 44 | — çë tue dredhur gjak të mirësh | nuk u loth e nuk pati dhimbë | as për pak ? Me të vërtetë\ çë s' u loth tue vrār? Njëmênt| 46 | — \ e të grymosur| 49 | — trimi e Franc Josifi\ edhe me ballë t' vrêrët | 50 | — e vërrēj me ballë t' vrêrët \ e vërrënte Franc Josifi,| 52 | — \+ shpinën|

δ 33 ja‖ j-a KT 35 drejtes‖ drejtës KT 36 e‖ i KT 38 ja‖ j-a KT

e che lascia convinti e meravigliati.
Così avvenne quando in Bece
il terribile vecchio di Asburgo
a Prenk Bib Doda disse apertamente:
– «Tu mi sei nemico come sempre,
da essere invero da annientare! »
A tali detti senza indugio
rispose l'ardito giovane:
– «Alla tua Maestà risplenda la corona;
ma la forza del Diritto
Iddio mantenga anche sul capo
dell'Albanese innocente,
come gliela ha sin oggi mantenuta!
Cosa sono io avanti a te,
Sovrano grande e senza limiti
nell'adempimento della volontà?
Cosa ero io poveretto
davanti a quel rosso Sultano,
che non si stancò di uccidere? Or ora
mi salvò l'Onnipotente
(che Egli mi protegga) e annientato
vidi coi miei occhi Abdul Hamidi
e la Turchia ridotta a mal partito !»
Tacque e con fiero cipiglio
lo squadrava Francesco Giuseppe,
ma legata aveva la lingua
per il rancore. Gli voltò le spalle

e pa fjalë e la, si n' zêmbërë
shpỹrti i zī kështu i bërtiste:
– «More Lang, e ku të kam?
Ku të kam, o Lang, i dashur?
Furkën ngreh, të lumen furkë,
mbâjsë e thronit, e tërkuzës
shkoi të lyemit për njê punë
që të kā për të fituar
mê t' kërkuamen kryqe t' ndērit...»
Mesandaj, si n' krahë t' erës,
ngā ata vise të mallkuarë
Prêng Bib Doda fluturonte
për në t' bukurat lulishte
t' Italīs, për n' ato fusha
çë blerojën fort pjellōre
nën njī qielli pa njê rēzë,
nën lëvdīs s' amshuame t' diellit.
Fati i mirë atje njê ditë
në katunt të lum e shpuri
të ku deshi t' kish nderime
Zonja e Shkodrës, kūr prej vêndit
iku e la të vjetrën qishë
mos të rrinte nd' anë t' Turkut.
Para korës të hierūshme
ishte i thekur e i pushtuam
edhe sỹt i kish ndër lotë.
Sā kujtime e sā shpëresa!
Prān për t' ardhur kish ndë vonë

β 58 tërkuzës] konapit KT1

γ 53 [— \ si n' zêmbërë] 54 [— \ kështu] 59 [— mê të fort e shko të lyemi\ shkoi të lyemit për njê pun] 60 [— përse ti do t' bêsh një punë\ që të kā për të fituar] 61 [— kryqen time mê t' kërkuamen \ mê t' kërkuamen kryqe t' ndērit...] *62-63* [— —] 65 [—\ për në t' bukurat] 68 [— qielli fort të kalthër,\ qielli pa njê rëzë,] 69 [—\ lëvdīs] 77 [— zêmbra i dridhej prej\ ishte i thekur e i pushtuam] 78 [— \ edhe sỹt i kish ndër lotë.] 79 [— \ — \— Sā kujtime e sā shpëresa! \ Sā kujtime e sā shpëresa!]

δ 68 njī]] nji KT 69 lëvdīs]] levdīs KT

e in silenzio lo lasciò, mentre nel cuore
l'anima nera così gli mormorava:
– «O mio Lang, dove sei?
Ove sei, o amato Lang?
Alza la forca, la felice forca,
sostegno del trono; e alla corda
dà il grasso, per un lavoro
che ti farà guadagnare
la più ambita croce onorifica».
Immediatamente, come sulle ali del vento,
da quei luoghi maledetti,
Prenk Bib Doda volava
per i deliziosi giardini
d'Italia, per quelle pianure
che verdeggiano fertilissime
sotto un cielo limpido,
sotto la gloria immortale del sole.
La buona ventura un giorno
nel paese beato lo condusse,
dove volle essere onorata
la Madonna di Scutari, quando dalla Patria
volò e lasciò l'antica chiesa,
per non restare vicino al Turco.
Avanti all'immagine divina
era commosso e conquistato,
ed aveva gli occhi in lacrime.
Quanti ricordi e quante speranze!
Sarebbe forse venuta più tardi

koha e thênë e Shqipërīs,
pas të zezavet ç' e ndrydhën,
e pas gjakut ç' e përviti?
Ngā fytyra e s' lartës Zonjë
si njê rreze pahi i dilte
edhe atīj i ndriste zêmbrën.
– «S' i harron njê mêmë t' bijëzit!...»
E në mênt i rā Margjela
çë s' e pati n' herë t' mbrame
që t' i mbyllte sŷt e lodhëtë
së vërrējturi në derë.
– «Përse vajte, o mêma e jime,
edhe shpīn më lē të shkretë!...»
Plaku frat që ruante qishën,
në kujtim ju qas tue thênë:
– «Po ç' e doni prap në Shkodër
të bekuamen korë t' Zonjës ?...»
Ju pergjeq: – «Ajo dī rrugën,
e, në daft, ashtu si jiku
munt t' këthehet. Na e përesim!».

γ 81-83 |— koha e thênë e Shqipërīs, \ koha e thênë e Shqipërīs,| pas të zezavet ç' e ndrydhën, | e pas gjakut ç' e perviti?| 95 | — «Prap në Shkodrë e doni Zonjën\ në kujtim ju qas tue thênë:|

δ 95 ju‖ j-u KT 98 Ju‖ J-u KT

l'epoca sospirata dell'Albania,
dopo le sventure che la strangolarono
e dopo il sangue che la soffocò?
Dall'immagine della gloriosa Signora
si dipartiva come un raggio di bellezza
che gli illuminava il cuore.
Non dimentica la madre i suoi figli!
E gli venne in mente Margjela,
che non lo ebbe nell'ora estrema
per chiuderle gli occhi, stanchi
di guardare dalla porta di casa.
– «Perché te ne andasti, o madre mia
e la casa mi lasciasti abbandonata?»
Il vecchio frate che custodisce la chiesa
pensieroso gli si avvicinò dicendogli:
– «La volete di nuovo a Scutari
la benedetta immagine della Signora?...»
Gli rispose: – «Essa conosce
la strada e, se vorrà, così come s'allontanò
può ritornare. Noi l'attendiamo!»

XXXIV

Nuk këthehet i ndërruam,
ndonse t' jashtit e kā tjetër.
Më nj' ahtim të zymti m' para
mpshihte shpȳrtin sy̑vet t' huajë;
nani qesh e napë ë̂ gazi
fort më̂ e mbrȳtë edhe se t' zymtit.
Buza i qesh e i shêmbet zêmbra
kūr më̂ duket pa kujtim,
e kūr adra then më̂ shumë
ndo njê̂ gozhdë e thër m' e madhe.
Êsht heshtimi disā herë
më̂ zhvillonjës se të folët,
edh' ai nuk do që luzma,
me kërkim të papërkorshëm,
në humnere t' vehtes s' tȳj
të veshtronjë thellë e çiltas.
Sā ndrishon kūr êsht i vetëm!
Po kā t' sy̑rit nuse t' mprehta
Ismaili e n' funt të zêmbrës
t' atīj sheh, si njê̂ dejtār,
çë nuk rrêhet prej qetimit.
Prān kështu me ndër i foli:
– «Nami i jyt u shtoft e vêndit
ti po i rrofshe sā Tomorri,
o Pasha, se me t' vërtetë

α KT1, KT3

β 16 çiltas.] ngelët. KT3

γ 9 |— \ adra then] 10 |— njê̂ \ ndo] 12 |— Êsht më̂ se t' folët\ më̂ zhvillonjës se të folët,] 13 |— \ që luzma,] *14* |—] *18* |—| 18 |— të\ kā t'] 19 |— Qemali e çiltas\ e n' funt të zêmbrës] 20 |— sheh në funt të zêmbrës s' tīj\ t' atīj sheh, si një dejtār,] *21* |— si |—dejtār] nj'i zot dejtār i vjetër\— shumë i zot e shumë i vjetër] 21 |— bunacës\ qetimit.] 22 |— \ me ndër] 23 |— jetës\ vêndit]

δ 3 ahtim]] afrim KT 13 ai]] aj KT 16 ngelët.]] nçelët. KT 20 atīj]] atij KT 25 Pasha]] Pashā KT

ε Napoli, 3 giugno 1917 <E njohim Nemtsen> 10 goxdë AB. 21 rrêthe B.

XXXIV

Non ritorna cambiato
per quanto abbia mutato sembiante.
Con accorata tristezza da principio
nascondeva l'animo agli occhi estranei;
ora ride, e velo è il riso
molto più cupo della stessa mestizia.
Gli sorride la bocca e gli si strugge il cuore
quando più sembra indifferente,
e dice facezie, ancora più
quando qualche chiodo più forte lo ferisce.
Il silenzio spesse volte
è più eloquente della parola,
ed egli non vuole che il volgo,
con curiosità intemperante,
nell'intimità del suo animo
scruti apertamente nel fondo.
Quanto diverso quando è solo!
Ma Ismail ha dell'occhio pupille acute
e in fondo al cuore
di lui vede, come un marinaio
che non s'illude della calma del mare.
Poi così con deferenza gli parlò:
– «La tua fama si accresca e alla Patria
tu viva quanto il Tomor,
o Pascià, che a dire il vero

kômbe t' tjerë mẽ̂ t' mëdhenjë
s' kanë edhe si ti dy burra.
Fort û prān jam i kënaqur
të të kēm te e bardha Vlorë
për me dhênë ndihmë t' madhe
neve, t' cilët, pā fuqī,
veç asāj çë del pa e thyeshme
prej të dashurit t' atdhēut,
dorë vûm në punë t' lartë
ndër rrëziqe e të vështira
çë nuk njihen dot. Po t' keqënj,
thuajmë ashtu si e kē në mênt.
Këjo punë do t' vē mbarë
pas të zênit e mẽ̂ mirë
pas dëshīrit tênë t' vjetrit,
nën të lartës hie mprojtāre
t' Italīs edhe të Nêmcen ?»
– «Në përgjigje t' plotë e t' drejtë
û nuk ndieja dot dëtyrën
tŷj me dhênë tash, o beg,
do të thoshëja si Turqit:
"Inshallah!" Po me të paka
thom edhe se në, pas fjalës,
e ti m' dî si burrë t' urt,
e kupton; ata ndyshime
çë s' të lên me krye të prêrët,
edhe shpŷrtin tim mundojën
ditë e natë… E njohim Nemcen!
Muntet kūrr njê plakë e keqe,

β 31 cilët,| cilët KT1 42 Nêmcen]] Nêmces KT1

γ 31 | — \ cilët] 34 | — \ lartë | 36 | — \ t' keqënj, | 37 | — si në mênt e kë, të keqënj. \ thuajmë ashtu si e kē në mênt.] 48 se | — ngashërimi\ — | në, 49 |—| ti | — \ si burrë t' urt,| 50 | — \ e kupton; ata ndyshime | 51 | — \ s' të lên me krye të prêrët, | 52 | - – \ shpŷrtin] 54 | — \ keqe, |

δ 31 fuqī]] fuqi, KT 32 asāj]] asaj KT 41 hie]] hīe KT 43 përgjigje]] përgjegje KT 46 do]] po KT 49 m'|| më KT 52 shpŷrtin]] shpyrtin KT

ε 49 më *Aa* B. 50 kupton se atà *Aa* B: espunto il «se» per esigenza di sintassi.

altre nazioni più importanti
non hanno due uomini come te.
Molto contento poi io sono
di averti nella felice Valona,
per dare grande aiuto
a noi, che, senza forza,
oltre quella che sgorga incorrotta
dall'amore della Patria,
iniziammo una grande opera
fra pericoli e difficoltà
non ancora conosciute. Ma, ti prego,
manifestami il tuo pensiero.
Questa impresa andrà a buon fine
dopo l'inizio e meglio ancora
secondo l'antico nostro desiderio,
sotto l'alta protezione
dell'Italia e dell'Austria»?
– «Se una risposta completa e giusta
io non sentissi il dovere
di darti ora, o Bey,
ti direi come i Turchi:
"Inshalláh!" Ma brevemente
dico che dal mio modo di parlare,
e tu mi conosci come uomo saggio,
V. *Non ti piace ubriacarti ? Ma l'essenza migliore dello spirito è quando esso si trova rapito in adorazione delle Divinità, quel momento deriva dall'ubriacatura. Il rapimento dello spirito è simile all'ubriacatura !*

T. *Può darsi; ma lasciami in pace.*

V. Në paqe, në paqe; por do të rrīsh në paqe gjith-monë ndë varrt tênt ! Eja të pīsh verë.

T. Nuk e kuptonjën gjithnjê të gjithë qetësīn, edhe unë e urrenj gjellën e kêndëshme.

V. Por ti rron si njê kërmill: e kupton ?

T. Mê mirë kërmill se mushkajë. (*Ndihen për së largu kênga të gëzuashme*)

V. Digjon ti për së largu miqët tanë? Ja se ç' thuhet sot trimërī: koha e gjallësīs, e bridhmës, e pakujdesīs. Mos mero këtê kohë të pā kujtoshme me punë të kota, me mendime të marrurë.

T. Por në unë të kisha ndë zêmrët njê dhêmbje që nuk më lê të jēm i gëzuar ?

V. Dhêmbje ? Trimëria s' dī këtê fjalë: dhêmbja ndë trimërī i glet hies e njī zogu që shkon, hie që ashtu si shihet, spavet.

T. Mjaft: nuk kē qajtur edhe, e nuk beson dhêmbjen. Nuk vinj dot: ec vetëm në trasgimī (*hapet dera me rrëmbim edhe ryn Juli*)

J. Traul, jē i ment-shkurtur por jē edhe i hieshim; sonte mos dil.

T. Nuk kam ngē të dalj.

J. Përse njê profit më dëfton se nestër do të të shoh të vdekur.

T. Muntet edhe.

V. Parathênësi u gënjye. Trauli êsht gjithënjê i vdekur, nuk pī, nuk dehet, nuk do mirë. Kā, thot, njê dhêmbje shumë të thellëtë ndë zêmrët.

J. Si, Valër, ti s' dī prā se Trauli do mirë ?

γ 202| — Na \\ Ja| 206 zêmrë[-- n \\ t] 212 trasgim|— it / ī| 217|parathênës \\ profit] 217-218 \të/ vdekur.

V. *In pace, in pace; ma starai in pace sempre nella tua tomba ! Vieni a bere vino.*

T. *Non la comprendono sempre la serenità, ed io aborrisco la vita spensierata.*

V. *Ma tu vivi come una lumaca: lo capisci ?*

T. *Meglio da lumaca che da zanzara.* (Si sentono lontani canti gioiosi)

V. *Ascolti tu in lontananza i nostri amici ? Ecco cosa significa giovinezza: il tempo della vitalità, del gioco, della trascuratezza. Non intristire questo momento indimenticabile con cose vane, con pensieri folli.*

T. *Ma se io avessi in cuore un dolore che non mi consente d'essere felice?*

V. *Dolore ? La giovinezza non conosce questa parola: il dolore in gioventù è simile a un uccello che passa, ombra che appena si intravede, scompare.*

T. *Basta: non hai pianto ancora, e non credi nel dolore. Non vengo affatto: vai da solo a godere* (si apre la porta con violenza ed entra Giulio)

J. *Traulo, sei ottuso ma sei anche avvenente; questa sera non uscire.*

T. *Non ho voglia di uscire.*

J. *Perché un vaticinio mi ha rivelato che domani ti vedrò morto.*

T. *Può anche essere.*

V. *L'oracolo si è sbagliato. Traulo è da sempre morto, non beve, non si ubriaca, non ama. Ha, dice, un dolore molto profondo nel cuore.*

J. *Come, Valerio, tu non sai dunque che Traulo ama ?*

V. S' muntet. Në nuk do mirë tjatër veç se dyfoljet të Platonit edhe hërnarin e tŷj që ndritëson punët e natëshmë.

J. Jo, jo; do mirë një grua.

V. Rron vallë më n' do vênt Aspasia, mikesha e Sokratit ?

T. Për Perëndirat, leni këta të folë.

J. Çë Aspasī vete tue thênë ti? Trauli do mirë një grua të plotë me vashërī, me fuqī edhe me bukërī.

V. S' besohet. Trauli do të dojë mirë n' do hie, a unë jam i marrur.

J. Ai do mirë Mesalinën.

V. Si thua? Si thua?... nuk dëgjova mirë. Thē Mesalinën?...

J. Po; ai do mirë Mesalinën me të nxeht, me besë, platonisht.

V. Traul, Mesalinë (*qeshën pā masë*) Mirë, shumë mirë. Muntet se ajo të ndeznjë tek ai ethet e zêmrës s' sāj... Eh ! Traul... thonë se Mesalina kā një gjī t' bukur; êsht një bukërī t' cilës një munt të qaset.

T. Miqë, më hidhëroni, me gjith-se nuk më doni lik, këta të folë më helmon, doni të pasoni ? (*ndihen jasht këndime*)

J. Na të folët u çā nga këndimet; përzita shkon jasht derës. Të falem, Traul; mos dil sonte. (*Juli edhe Valeri venë*)

T. (*tuke mbyllur derën me kujdes*) Pa digjo se çë thërresnjën trimërī! Thonë t'ārtë atê kohë, jo përse ndihemi të fortë për të bêrë ç'do të mirë, por përse jemi të zotëra të qëndrojëm përpara ç'do të keqëje... (*trokullitnjën derës*). Le të trokullitnjën aqê sā t'duan, por unë nuk hap mê. (*trokullitnjën mê fort*). Por këjo gjê s'munt të duronet. Kush êsht?

M. (*jasht*) Liqiska, kurva.

T. Gënjene, nuk kërkon këtê derë.

β 241 hidhëroni,] idhëroni, MS

γ 226 [— të \ e] natëshmë [—t' tŷ]|. 245 |— Na \\ Pa digjo se] 246 [— Thërresjën ari \\ Thonë t' ārtë] 247 qëndrojëm[— ë] 249 \t'/ 250 \të/

V. *Impossibile. Egli non ama altro che i dialoghi di Platone e la sua lanterna, che gli illumina le cose abbuiate.*

J. *No, no; ama una donna.*

V. *Vive forse in qualche parte Aspasia, l'amichetta di Socrate ?*

T. *Per gli Dei, abbandonate questi discorsi.*

J. *Di quale Aspasia vai dicendo tu ? Traulo ama una donna molto giovane, vigorosa e molto bella.*

V. *Incredibile. Traulo amerebbe un'ombra, oppure io sono pazzo.*

J. *Egli ama Messalina.*

V. *Cosa dici ? Cosa dici ?... non ho sentito bene. Hai detto Messalina ?...*

J. *Sì; ama Messalina con calda passione, fedelmente, platonicamente.*

V. *Traulo, Messalina* (ride intensamente) *Bene, molto bene. Potrà darsi che ella trasmetterà a lui la febbre del suo cuore ... Eh ! Traulo ... dicono che Messalina abbia un bel seno; è una bellezza alla quale uno si può avvicinare.*

T. *Amici, mi affliggete, benché non mi vogliate male, questo parlare, mi avvelena, volete continuare ?* (si odono fuori canti)

J. *Ecco la disputa è stata interrotta dai canti; la comitiva passa qui davanti. Ti saluto, Traulo; non uscire stasera.* (Giulio e Valerio escono)

T. (chiudendo la porta con cura) *Senti un po' che cosa chiamano giovinezza ! Dicono d'oro quel periodo, non perché siamo liberi di fare qualcosa di buono, ma perché siamo liberi di soffermarci dinanzi alle cose cattive ...* (bussano alla porta), *Che bussino quanto vogliono, ma non apro più* (bussano più forte). *Ma questa cosa è insopportabile. Chi è ?*

M. (da fuori) *Licisca, la prostituta.*

T. *Ti sbagli, non cerchi questa casa.*

M. Liqiska kurva kërkon Traulin.

T. Montani s'kā çë të bênjë me kurvat (*ndër vetëhe*) Kī zê më mallnjen.

M. Hap, a rrëzonj derën.

T. Unë hap; por mjera ti në më merzitëshe. (*hap derën edhe rŷn Mesalina bashk me Oktaviën. Këjo êsht gjithë e zbeturë. Mesalina e veshurë si njê kurvë kā krahët gjymësma të zhveshurë, edhe flokun me shumë rruaza edhe me gurë t' pā çëmuara*)

T. Mbretëresha !

M. Mbretëresha? gënjene, lash shqepin në pallat, jam Liqiska kurva.

T. Oh! êndërrat e mia! ishën të vërteta prā gjithë ato që thuheshin! Mesalinë, Mesalinë!

M. Thërritmë Liqiskë.

T. Për mua jē gjithnjê Mesalina. Isha i marrur, edhe besoja se ligësia edhe zilia të dëftonjën të flliqurë me balltin e kurvërīs. Më të dëftojën mbrêma për mbrêma në dhomët të goshtīs, në triudhat, ndër përqafimet të t'parit t'ardhur, edhe tuke ndējtur shqepin për në dhē mos gurët të t'bêjën keq, edhe unë i shaja sikūrse të kallnjën: edhe kishin ligjë.

M. Mjaft. Me t'parin t'ardhur thē? Gënjene. Me të bukurit vetëm. Dua mirë bukurīn edhe e kërkonj te ku do: êsht kjo njê gjê e pā ndërshëme?

T. Bukuria? Oh! ti e pergon, ti pergon këtê hie t'Perëndivet me njê adhurim të pā ndērshim edhe kafshash, me të dehurit, me kurvërīn, me keqësīt edhe me të tjera ligësī të tilla.

M. Oktavie, ipmë pasqirën: më mesonjën urtësīn, duket se unë jam bêrë plakë, a se fytyra ime u ndërrua.

β 269 dhomët] domët MS

γ 259 gj]u /y]mësma 271 ndēj[—i]tur 275 ndërsh[i +\ ë]m[ë /e] ? 277 ndērshim[— ë]

M. *Licisca la prostituta cerca Traulo.*

T. *Montano non ha nulla a che fare con le prostitute* (fra sé e sé) *Questa voce mi attira.*

M. *Apri, oppure abbatto la porta.*

T. *Io apro; ma povera te se mi inopportuni.* (apre la porta ed entra Messalina con Ottavia. Questa è molto pallida. Messalina vestita come una prostituta ha le spalle mezze scoperte, e i capelli con molti anelli e con pietre preziose)

T. *L'imperatrice !*

M. *L'imperatrice ? ti sbagli, ho lasciato il velo nel palazzo, sono Licisca la prostituta.*

T. *Oh ! i miei sogni ! erano vere dunque tutte quelle cose che si dicevano ! Messalina, Messalina !*

M. *Chiamami Licisca.*

T. *Per me sei sempre Messalina. Ero pazzo, e credevo che la cattiveria e la gelosia ti mostrassero sporca con il fango della lussuria. Più ti mostravano di sera in sera nelle sale del banchetto, nei tridui, negli abbracci del primo arrivato, ed anche stendendo il velo per terra perché le pietre non ti ferissero, ed io le maledicevo come se ti infilzassero: ed avevano ragione.*

M. *Basta. Col primo arrivato hai detto ? Ti sbagli. Con i belli solamente. Amo la bellezza e la cerco ovunque: è questa una cosa disonorevole ?*

T. *La bellezza? Oh ! tu la sporchi, tu sporchi questo dono degli Dei con un'adorazione indecorosa e bestiale, con l'ebbrezza, con la lussuria, con la malvagità e con altre scelleratezze. simili*

M. *Ottavia, dammi lo specchio: m'insegnano la saggezza, pare che io sia invecchiata, oppure che il mio viso si sia trasformato.*

T. Të thom me të vërtetë se jē shumë e bukurë. Jē e bukurë si Afërdita; por si Afërdita Pandemja, të nqiellshëmen nuk e kujtove kūrr?

M. Nuk erdha këtu se mesonja mirëvetjën, e kupton, unë kam shpresë.

T. Shumë mirë, besonje se mua më duhej Liqiska, kurva, por u gënjeve.

M. Mos jē ti ?

T. Jam burrë, por kam zêmrë edhe shpȳrt. Mesalinë, êsht njê burrë në Rromë i cili të do mirë me të vërtetë, i cili vështron këtê bukërī, çë êsht e perguarë nga të puthuritë të poshtërë, e i cili bêri bē të puthinjë ato buzë, vetëm kūr nuk do të jën puthurë nga të tjerë. Kȳ burrë mendoi të vrasnjë Mesalinën, edhe të vênjë mbi buzët e saja ndë t' vdekur, njê t' puthur, çë t' mos shuhet kūrr.

M. Kȳ burrë a êsht i lênë a êsht i lik. Traul, sa ti kē mendime kaq të shtrêmbërë, ndien ti te zêmra jote fuqīn të më duash për gjith-monë edhe me besë, pā u lodhur kūrr; pā zbjerrë as për pak êmbëlsīn e ditëvet të para, pā pasur frik për pleqërīn time, pā pasur urrim në fund kūr të më vështronsh edhe pā thênë ndo herë si ti munt t' më kēsh dashur mua ?

T. (*me të nxehtë*) Atëherë do të rronsh e thjellëtë ? Nuk do të pergonsh mê këtê bukërī, që pate sā t' ishe e adhuruarë si njê Perëndī ? Unë ndienj, Mesalinë, këtê fuqī, edhe dafshe, provomë.

M. Pā ndyshim, a provimi nuk do të vē mbarë, a ti nuk kē shpȳrt.

T. Nuk kam unë shpȳrt, Mesalinë ? Talle ti ?

M. Unë nuk tallem; por hidhërohem se ora shkon kot, edhe me atê edhe trimëria jonë.

T. Kē kūrr dashur mirë ti, o Mesalinë ?

β 301 <të> 302 <më> 311 hidhërohem|hidhërohem MS

γ 311 \Unë/ nuk tallem [— unë];

T. *Ti dico in verità che sei molto bella. Sei bella come Venere; ma come Venere Pándemos, la celestiale non l'hai mai ricordata ?*

M. *Non sono venuta per imparare l'onestà, lo comprendi, io ho speranza.*

T. *Molto bene, credevi che mi occorresse Licisca, la prostituta, ma ti sei sbagliata.*

M. *Forse lo sei tu ?*

T. *Sono un uomo, ma ho cuore e spirito. Messalina, vi è un uomo in Roma che ti ama veramente, che ammira questa bellezza, che è insudiciata dai baci corrotti, e che ha promesso di baciare quelle labbra, soltanto quando non saranno più baciate da altri. Quest'uomo pensò di uccidere Messalina, e di deporre sulle sue labbra mentre moriva un bacio, affinché non si spegnesse mai.*

M. *Quest'uomo o è pazzo oppure è cattivo. Traulo, per quanto tu abbia pensieri così distorti, provi tu nel tuo cuore la forza d'amarmi per sempre e fedelmente, senza stancarti mai; senza perdere anche per un attimo la dolcezza dei primi giorni, senza aver paura della mia vecchiaia, senza odiarmi infine quando mi guardi e senza dirmi qualche volta come potesti tu amarmi ?*

T. (con passione) *Solo allora vivrai pura ? Non sporcherai più questa bellezza, che avesti per essere adorata come una Dea ? Io provo, Messalina, questa forza, se tu lo volessi, mettimi alla prova.*

M. *Senza dubbio, o la prova non avrà successo, o tu non hai spirito.*

T. *Non ho io spirito, Messalina ? Scherzi tu ?*

M. *Io non scherzo; ma mi infastidisco perché il tempo passa invano, e con esso anche la nostra giovinezza.*

T. *Hai mai amato tu, o Messalina ?*

M. (*Me ballë të vrêrët*) Nuk kujtonem; përse më pyet këtê gjê ?

T. Kē qênë kūrr e përdhênë ?

M. (*Me ballë të vrêrët*) Traul, dua mê mirë, hidhërimin tênt, se këto të pyetura.

T. Por kë do ti t' kësh dashur mirë, sā t' math të jēt të përdhênët, edhe dyshpërimi yt, unë munt të t' kënaq; në drita shumë e madhe verboi zêmrën tênde, unë munt të t' e ndritësonj përsërī mê êmbël edhe mê ndurisht.

M. (*Tuke shkuar dorën mbi ballët si për të përzênë një kujtim të dhêmbëshim*) Jē djalë gjithënjê. Mesalina nuk kupton këtê dashurī të vakëtë të t' marrëvet, ajo do dashurī zjarri.

T. Por e vërteta êsht se unë të dua mirë, Mesalinë, edhe nuk kē të drejt të pergonsh fytyrën tênde që êsht gjithënjê e gëdhêndur ndë zêmrët time: në ajo nuk êsht e besëmë, në ajo nuk i ngjān fare të vërtetës, por atëherë êsht e bêrë prej meje, Mesalinë, edhe mosnjerī kā të drejt të prishnjë punën time, të rrëzonjë êndërrën time. Të lutem, mbretëreshë, ik, mos të jësh aqê e ligë, mos të rrëzonsh të vetëmen, edhe përandaj shumë të fortën dashurī time.

M. Mjeri ti, jē i lênë !

T. Jam, muntet; mos përqesho prān marrësīn time, përse do të jet për mua vdekëje.

M. (*Tuke vështruar një dorëshkruamë*) Kȳ vëllym do të jēt pā ndyshim i Platonit.

T. Êsht *Simposi* i Paltonit.

M. Ipme, nuk jam e pā diturë në filosofīt. Beson ti te mesimet e këtīj filosofi ?

T. Aqê sā ti i shkërcen.

M. Gënjene; unë nderonj filosofin, i cili rronte njê gjellë shumë të pëlqieshme, edhe dēj mirë si duhet. Digjo prā: (*zgleth*)

β 316 hidhërimin| idhërimin MS

γ 322 kujtim |i / të| 324 vakët|a / ë| 328 vërtet[it + ës], 332 fortë\n/, 339 Ipm|ë / e|, |— të \\ e| 343 t[e / ë]

M. (Con la fronte corrucciata) *Non ricordo; perché me lo chiedi ?*

T. *Sei mai stata violentata ?*

M. (Con la fronte corrucciata) *Traulo, preferisco più la tua afflizione che queste domande.*

T. *Ma chiunque tu avrai amato, per quanto grande siano la violenza, e la tua disperazione, io posso compiacerti; se la grande luce accecò il tuo cuore, io posso illuminarlo di nuovo più dolcemente e più a lungo.*

M. (Passando la mano sulla fronte come per afferrare un pensiero doloroso) *Sei giovane sempre. Messalina non capisce questo amore tiepido dei folli, lei vuole amore ardente.*

T. *Ma la verità è che io amo, Messalina, e non hai il diritto di macchiare il tuo viso che è sempre scolpito nel mio cuore: se esso non è credibile, se esso non somigli affatto alla verità, ma allora è creato da me, Messalina, e nessuno ha il diritto di rovinare i miei piani, di distruggere il mio sogno. Ti prego, o imperatrice, vattene, non essere così crudele, non annientare la mia coscienza, ed anche il mio fortissimo amore.*

M. *povero te, sei pazzo !*

T. *Lo sono, può darsi; non deridere dunque la mia follia, perché sarebbe per me come la morte.*

M. (Osservando un manoscritto) *Questo volume sarà senza dubbio di Platone.*

T. *È il* Simposio *di Platone.*

M. *Dammelo, non sono ignorante in filosofia. Credi tu negli insegnamenti di questo filosofo.*

T. *Tanto quanto tu li disprezzi.*

M. *Ti sbagli; io ammiro il filosofo, il quale viveva una vita molto gradevole, ed amava come occorreva. Ascolta dunque:* (legge)

«Duhet se ai që me drejtësī zẽ fill këtẽ gjẽ ta zênjë që kūr êsht trim t'i qaset kurmevet të bukurë edhe ndë të zênët, në êsht i dreqësuar mirë të dēt njê kurm të vetëm, prā (*me zẽ mẽ të lart*) tuke kuptuar se bukurīa që êsht te njê kurm êsht e motra e bukurīs që rrī në njê tjatër, edhe se në duhet të kërkonjë gjithë ato gjẽra që kanë pamje të bukurë, doj' t'ishte marrësī e madhe, të mos besohej se êsht njê edhe e vetë bukuria që ndodhet te gjithë kurmat. Tuke kuptuar këtẽ gjẽ duhet të dojë mirë gjithë kurmet e bukurë, edhe të lërenjë ata të nxcht të parë për njê kurm të vetëm, tuke shkërcyer edhe tuke kujtuar këtê si njê gjẽ pā rëndësī». Digjon ti, Traul? kupton se unë filosofonj mẽ mirë se ti? Të qênët tim êsht të tillë: adhuronj bukurīn te ku e përpjek, edhe s' rruanj njeriun. Trauli kā sȳ të kalthërë e t'bukurë, prā adhuronj të bukurit sȳ t'tȳj. Sili kā njê bukurī burrërishte, adhuronj Silin.

T. (*tuke u zbetur*) Silin ti thē? edhe do mirë shumë këtê Sil?

M. E dua mirë pā masë, aqê sā dua tīj; njeri nuk përzẽ tjatërin.

T. Nuk kuptonj këtê filosofī. Çë kē ardhur tuke kërkuar këtu?

M. Njê çast lumërie: erdha të përgëzonja këtê kokë të lênë, edhe të puthija këto buzë çë thonë fjalë të kota.

T. Lemë; buzët e mia nuk pergonen: më tjatër vênt kërko të puthura të tilla: Trauli nuk i kupton.

M. Oh! puna merr rëndësī, edhe mejton mirë, Mesalina merr shpagim të thārt mbi ata që e ftesjën; por ndër këtê (*përvesh krahët*) thonë se pamja e bukurīs mallnjen edhe bishat, vështro, e në ti ishe edhe Minerva doje të bije.

T. (*Tuke mbyllur sȳt*) Jam i verbur.

M. (*e hidhëruarë*) Me të vërtetë prā ti dishiron errësirën e vdekëjes? Por unë do të të vras, Montan. E kupton? Ti vetëm nuk më kē marrë vesh, edhe do të vdeç.

β 374 hidhëruarë] idhëruarë MS

«Occorre che colui il quale rettamente inizia questa cosa, che incominci quando è giovane ad avvicinarsi ai bei corpi e dapprima, se è ben guidato, vorrà un corpo soltanto, poi (a voce più alta) comprendendo che la bellezza che è in un corpo è la sorella della bellezza che sta in un altro, anche se non occorra che cerchi tutte quelle cose che hanno un aspetto bello, sarebbe follia grande il non credere che sia una e la stessa la bellezza che si trova in tutti i corpi. Comprendendo questo occorre che ami tutti i corpi belli, e di lasciare quella passione iniziale per un solo corpo, trascurando e ricordando questo come qualcosa senza importanza» [Simp., XXVIII, a-b]. *Ascolti tu, Traulo ? capisci che io filosofeggio meglio di te ? L'essenza mia è tale: adoro la bellezza dove la incontro, e non considero il singolo uomo. Traulo ha occhi puri e belli, dunque io adoro i suoi belli occhi. Silio ha una bellezza maschia, adoro Silio.*

T. (impallidendo) *Silio hai detto ? e lo ami molto questo Silio ?*

M. *Lo amo senza misura, quanto amo te; l'uno non si confonde con l'altro.*

T. *Non comprendo questa filosofia. Cosa sei venuta a cercare qui ?*

M. *Un attimo di felicità: sono venuta a rallegrare questa testa pazza, e a baciare queste labbra che emettono parole inutili.*

T. *Lasciami; le mie labbra non si insudiciano: altrove cerca baci simili: Traulo non li giustifica.*

M. *Oh ! la cosa diventa interessante, e pensaci bene, Messalina si vendica duramente di coloro che la offendono; ma per questo* (scopre le spalle) *dicono che la vista della bellezza invoglia anche le belve, guarda, e anche se tu fossi Minerva dovresti cedere.*

T. (chiudendo gli occhi) *Sono cieco.*

M. (irata) *Veramente dunque tu desideri il buio della morte ? Ma io ti ucciderò, Montan. Lo capisci ? Tu soltanto non mi hai dato ascolto, e morirai.*

T. S'i vê rē. Ndër mes njī poshtërsie të përgjithshme mbeta i thjellët si Dielli, kūrr u kretha ndë balt t'kêndavet të djelmërīs. Adhuronj të mishruarit të kurvërīs; êsht zjarri që deshi mirë ujët; do të shuhet tek ata. Me ligjë ti do të më vraç. Por do të vdes ashtu si rrova, me besë në dashurīt.

M. Traul, mbretëresha të lip njê të puthur.

T. Buzë të bukura janë shumë e shumë; më tjatër vênt ec për të kërkuar të puthura.

M. (*Përgëzon flokun e tyj*) Traul, vështromë; nuk jam unë e bukurë? (*E përqafon*) Të lutem, njê të puthur, njê t'puthur vetëm; do verë? Eja se dehemi bashk; do t'apim urdhër që të ndezjën shumë flaka, të bien lule, edhe tek qëmbojën dhomat për armonī, na do t'krethemi te rrêmbimi i shpyrtit. (*Trauli unj kokën*) Njê t'puthur, Traul; na përqafonj gjunjët e tū; na unë përunjem përpara tij, si e mê poshtëra ndër grāt. (*Trauli e ngrên edhe e përqafon*)

O. (*e trëbulluarë*) Mesalinë, vjen Sili.

T. (*Tuke shtitur Mesalinën*) Sili ! ec tek ai të të puthnjë.

M. Atëherë vdis prā (*helq thikën edhe e kreth te zêmra e tyj. Trauli bie*). Tashti unë munt t' puth buzët e tua përse janë edhe të ngrohta. (*Unjet përpara Traulit*)

O. Mesalinë, Sili të thërret.

M. Korbëravet ! (*ngrên kokën e Traulit*)

O. (*Merr Mesalinën edhe e helq jasht derës*) Por të thërret Sili. (*lê Mesalinën jasht derës edhe këthehet, përqafon Traulin edhe ep atyj njê t'puthur të gjat*) U gënjeve Traul; përse nuk deshe mirë mua, çë aqê të desha mirë (*Helqi thikën nga krahërori i Traulit edhe vritet*)

M. (*Këthehet*) S'ish njerī (*tuke pār të dy të vdekurit*) Oktavie? Çë? Oh ! E marrura ! Na se çë thërresjën dashurī!

Funt

β 389 dhomat] domat MS 405 dy <të> vdekurit

γ 379 |— mishrimin \\ të mishruarit| 391 /përunjem\ 399 Korb|e \+ ë|ravet! 405 Oktavi[ë \+ e] 406 /se\

T. *Non m'importa. Dinanzi ad una volgarità generale sono rimasto puro come il sole, mai mi sono immerso nel fango dei piaceri della gioventù. Adoro l'incarnazione della lussuria; è il fuoco che amò l'acqua; si spegnerà in essa. A ragione tu mi ucciderai. Ma morirò così come ho vissuto, fedele all'amore.*

M. *Traulo, l'imperatrice ti chiede un bacio.*

T. *Labbra belle ce ne sono moltissime; altrove vai a cercare baci.*

M. (ravviva i suoi capelli) *Traulo, guardami; non sono io bella ?* (l'abbraccia) *Ti prego, un bacio, un bacio soltanto; vuoi del vino ? Ubriachiamoci insieme; ordineremo di accendere molti fuochi, di portare fiori, e mentre risuonano le stanze d'armonia, noi ci immergeremo nel rapimento dello spirito.* (Traulo abbassa il capo) *Un bacio, Traulo; ecco che abbraccio le tue ginocchia; ecco che mi prostro dinanzi a te, come la più volgare fra le donne.* (Traulo la solleva e l'abbraccia)

O. (agitata) *Messalina, viene Silio.*

T. (Scostando Messalina) *Silio ! Vai a farti baciare da lui.*

M. *Allora muori dunque* (estrae il coltello e lo infilza nel suo cuore. Traulo cade) *ora io potrò baciare le tue labbra perché sono ancora calde.* (Si inginocchia davanti a Traulo)

O. *Messalina, Silio ti chiama.*

M. *Ai corvi !* (solleva il capo di Traulo)

O. (Afferra Messalina e la trascina fuori della porta) *Ma ti chiama Silio.* (lascia Messalina fuori dalla porta e rientra, abbraccia Traulo e gli dà un lungo bacio) *Hai sbagliato Traulo; perché non amasti me, che tanto ti amai* (estrasse il coltello dal petto di Traulo e si uccise)

M. (Ritorna) *Non c'era nessuno* (vedendo i due morti) *Ottavia ? Che cosa ? Oh ! La pazza ! Ecco che cosa definiscono amore !*

Fine

Të mishëruamit
të sprasëm të Mantnērit

L'ultima incarnazione di Mantneer

Kështu thot i lashti i ditur:
Nuk kā gjêra t' rē nën diellit,
se të gjita ato çë janë
klenë, edhe, dëftime t' Zotit,
ç'ê prej vehtes qysh nj' amshimi,
për gjith-monë do të jën.
Mosgjê bênet prej mosgjêjet
e n' mosgjê nuk sos gjagjê,
se çë s' êsht nuk mûnt të jët
edhe ç' êsht nuk mûnt t' mos jët.
Si i Paprishëmi, ngā i cili
ê gjithshtëja e përshkuame,
nuk vdes kūr, përse nuk lindi,
ashtu shpyrtin, frŷmë t' tij,
s'e pret thika, s' e djek zjarri,
s' e lak ujët, s'e thān era.
Kurmi i vetëm êsht i rênshëm,
i ndërroshëm edhe i ndāshëm
në të thjeshtit fije t' parë.
Po si t' veshurat e vjetra
lê njeriu, dhe merr të rāt,
ashtu shpyrti; tuke lênë
të vjetruamit, kohë m' kohë,
kurme t' rī po merr, çë njihen
si caktime t' tij në lêndë,
do ngā ajo fuqī e ndërlëme
ç' e shtrëngon të mishëronet,
për të pasur vegle t' ndiemi,
sā edhe mê të përparonjë
në të kryem çë s' kā të sosur;
do pas punavet çë n' jetë
të përparëshme ai bêri

γ 1-2 \Kështu thot [— \ i lashti] i ditur: [Nuk kā gjêra \t'/ rē nën diellit,/ 20
veshur[\ + at] vjetr[ë \ + a] 21 [— \ rāt,]

Così dice il sapiente antico:
Non ci sono cose nuove sotto il sole,
poiché tutte le cose che esistono
già esistettero, e manifestazioni di Dio,
che è da per sé fin dall'eternità,
per sempre esisteranno.
Nulla si crea dal nulla,
e nel nulla non finisce alcuna cosa
poiché ciò che non esiste non può esistere
e quel che esiste non può non esistere.
Come l'Indistruttibile, dal quale
tutto l'universo è compenetrato,
non muore giammai, perché non nacque,
così l'anima, soffio di lui,
non lo ferisce il coltello, non lo brucia il fuoco,
non la bagna l'acqua, non la secca il vento.
Il solo corpo è caduco,
mutabile e divisibile
nei suoi primissimi elementi semplici.
Ma come le vesti vecchie
lascia l'uomo e prende quelle nuove,
così l'anima, abbandonando
quelli invecchiati, di tempo in tempo
riprende corpi nuovi, che sono
come la sua determinazione nella materia,
sia per la forza innata
che la costringe ad incarnarsi,
per avere organi di senso,
affinché sempre più progredisca
nella perfezione che non si raggiunge mai;
sia giusta le azioni che nella vita
precedente essa compì,

e çë t' rrjedhëshmi njī shteti,
në t' rishlindurit, e lidhën.
Po sā do edhe do çë t' zbresnjë
posht në shkallë t' hies njeriu,
kūrr ai nuk munt të duhet
prap mbi tokën me fytyrë
të ndo shtêzëje t' pafjalë,
a si drû, si bār, si bimë,
për ndeshkun të vjetrish faje.
Kush e pā, me të vërtetë,
grûrin kūrr ngā fara e lîrit ?
Kush të bînjë e pā kūrr lisin
ngā mbërthama e zeshkë e dardhës ?
Bëjën fajet e mëdhenjë
që të ngryset drita e shpyrtit,
jo që krejt ajo të shuhet;
se ndomos e kurmit trajta
s' munt të kishte amshim; pā thênë
se do t' ishe i kot mundimi
e njī lêndje pā vetdije,
për qëllim tuke mos pasur
të njeriut t' përmirësuarit.
Si në zjarr kullonet āri,
ashtu shpyrti. Ai me mundë
shdrivillonet dal' e dalë
e me t' dhëmbur, jetë m' jetë,
kurm tue marrë e tuke e lênë,
ç' êsht të lēr dhe të vdekur,
ngjēr çë dheu do t' kēt të gjallë;
për me zênë prap të sjellë,
pā pushim e për gjith-monë,
në mê t' mirë rruzullime
të hapsirës të pamegje.
Na mëson i dishmi i motit

γ 35 | — të\ çë t' | 59-60 | — tuke ler e tuke vdekur, | tuke vdekur e tuke lēr, \ kurm tue marrë e tuke e lênë, | ç' êsht të lēr dhe të vdekur,| 66 \ Na mëson i dishmi i motit/

e che una condizione conseguente,
nella rinascita, la avvinsero.
Ma per quanto possa discendere
giù nella scala della dignità umana,
giammai essa potrà apparire
di nuovo in terra coll'aspetto
di qualche bruto privo di parola,
o come albero, o come erba, o come pianta,
in espiazione di antichi falli.
Chi vide, in vero,
germogliare il grano dal seme del lino ?
Chi germogliare vide mai la quercia
dal seme bruno della pera ?
L'anno le grandi colpe
oscurare la luce dello spirito,
ma non la spengono del tutto,
altrimenti la forma del corpo
non sarebbe immortalato; senza dire
che sarebbe inutile il castigo
di una materia priva di coscienza
se non avesse per fine
il miglioramento dell'uomo.
Come nel fuoco si purifica l'oro,
così anche l'anima. Essa con travaglio
si evolve lentamente
e con dolore, di secolo in secolo,
incarnandosi e disincarnandosi,
il che è il nascere e il morire,
finché la terra avrà dei viventi;
per riprendere un corso nuovo
senza un riposo ed in eterno
in mondi migliori
dello spazio privati confini.
Ne ammaestra il sapiente del tempo antico

tue na thênë se, në qênsë,
trī tipare çillësī
kā në vehte Lênda e parë,
çë nuk pati kūrr fillim,
po si edhe s' e pati Shpyrti;
e po shton se, n' lêndë i zênë,
çilësīt tue përdoruar,
me ato shpyrti përbashkonet,
e se kȳ bashkim ê shkaku
i të lêmit ngā të mirë,
a ngā prêhëre të keqë,
pas të dalit t' njīj prej tyre
po mbi tjerat. Vjen më rār
se njeriu, te jeta e rē,
pemën mleth të punës s' vetë,
pas të dalit t' mirësīs
për mbi māll edh' errësirë;
a të māllit për mbi t' parën
e të tretën; a t' kësāj
për mbi t' parën e të dȳtin.
Gjithë ata çë n' mirësī
qillon fati i pashpëtoshëm,
zên te jeta t' lertit vênde
të dies s' madhe. Ata çë kurmin
lên në māll, kūr u vjen koha,
linden prap sā t' bêjën punë
dhe të kēn dëshira t' nxehtë
e guzim e të paprêjtur
e pushtet e ngashërime.
Ata prān, çë n' errësirë
vdekja gjēn, në shqyfe t' liqë
mishëronen, për me rruar
si frymorë të pamêntë.
Por e kā, sā do çë t' voglë,

γ 67 \ tue na thênë se, në qênsë,/ 72 [— prān kūr ê në\ e po shton se,] 96 [— Prān ata, \ Ata prān,] 97 [— poshtrë\ liqë]

dicendo che, in sua essenza,
tre qualità caratteristiche
ha in sé la materia primordiale,
che non ebbe mai principio,
così come non l'ebbe lo spirito;
ed aggiunge che, stabilitasi nella materia,
adoperando le qualità,
con esse l'anima si congiunge,
e che tale congiunzione è la causa
della nascita da buone
o da cattive matrici;
secondo il prevalere di una di quelle
sulle altre. Vuol dire
che l'uomo, nella nuova vita,
raccoglie il frutto della sua azione,
secondo il prevalere della bontà
sulla passione e sulla tenebra;
o della passione sulla prima
e sulla terza; o di questa
sulla prima e sulla seconda.
Tutti coloro che nello stato di bontà
colpisce il fato inevitabile,
raggiungono in vita gli altri luoghi
della somma sapienza. Coloro che il corpo
lasciano nello stato di passione, al tempo stabilito
rinascono per l'azione,
e per avere desideri ardenti
e coraggio e mancanza di riposo
e potenza ed affanni.
Coloro poi che in istato di tenebra
la morte trova, in uteri cattivi
s'incarnano, per vivere
come animali privi di giudizio.
Ma conserva, per quanto piccola,

njê shkëndijë t' zjarrit t' shêjt
dhe m' i poshtëri në vehte;
po sā t' rritet e prej tymit
të shpëtonjë, mê shumë
mot i vê, se sā njī pike
mûnt t' i duhej të dërptonte
rruzullimin anë e mb'anë,
n' ishte kȳ njê shkrap i dêndur.
Kā edhe njerëzë të rallë
te ku do, më çëdo rrênde,
çë punojën pas dëtyrës
çë ngā shteti u vjen i jetës,
tek i cili janë e ndodhen.
Fare ata shpagim nuk presin
edhe i lê gjithnjê lëvdia
e të sharët, ashtu kênda
si të dhêmburit, e vapa
si të ftohtit. Nuk helmonen
për të keqe e për të zeza;
nuk gëzonen për të mbara;
shumë t' maturë e të drejtë
do me miq' e do me armiqë,
me gjërīn e me të huajit,
njohin vllezërë të gjithë;
dêshirime s' kanë e urrye;
aqë bêjën ār e rrgjênt,
sā po gurin edhe botën,
edhe i falin Zotit pemën
e të bêmavet të veta.
Ata janë si edhe diell;
çë menatnet del për gjithë,
për të mirë e për të liqë,
e çë t' gjitha ndrit e ngroh.
Çilësīt kështu të tria,

γ 103 | — ndonse \ po sā| 108 | — gjellë\ kȳ | 110 rrên| t \ + d|e, 124 \ njohin vllezërë të gjithë;/

una scintilla del fuoco sacro
anche il più vile dentro se stesso,
ma perché cresca e dal fumo
giunge a liberarsi; essa maggiore
tempo dovrà impiegare che quanto ad una goccia
potrebbe occorrere per forare
il globo da una parte all'altra,
se questo fosse un gran tutto compatto.
V'ha degli uomini rari,
in ogni luogo ed in ogni classe,
che operano secondo il dovere
loro derivante dallo stato della vita
nel quale sono e si trovano.
Essi non attendono veruna ricompensa
e li lascia indifferenti la lode
ed il biasimo, così pure il piacere
come il dolore, e il caldo
come il freddo. Non si affliggono
per mali e per sciagure;
non gioiscono per eventi favorevoli;
molto equanimi e giusti
sia con amici e sia con nemici,
col parentado e con gli estranei,
riconoscono tutti come fratelli,
non hanno né desiderii, né repulsioni;
apprezzano tanto l'oro e l'argento,
quanto la pietra e la gleba,
ed offrono a Dio il frutto
della loro opera.
Essi sono come il sole,
che in sul mattino sorge per tutti,
per i buoni e per i malvagi,
e che ogni cosa illumina e riscalda.
Le tre qualità in tal guisa,

shkake kurmesh, kapërcejën,
as trishtimi, as dīn të mblakur
e lironen për gjith-monë
ngā rishlindëja e ngā mora;
përse i lumi shpȳrt i tyre,
pas të ndāmit, shkon e vete
në një tjatër ȳll mё t' mirë.
As harrojën n'ato vise
dheun e vjetër, ku mё parë
patën ndênjë e te ku lanë
disā tjerë, po në munë
të përhershme e t' vështirë;
si s' harron shtëpīn e prindit,
te ku u rrit, si lule e bukurë,
e dëlirë nuse e rē,
ndonse e lume tek e veta.
Prān andaj na hidhen rreze
dashurije të hieruashme
e veshtrimi të pavdekshëm,
çë përpjet na helqin zêmbrën
edhe mêndëjen na ngrehin,
po si hênxa t' dējtit valët.
Ndër ata kështu e me dheun
janë hyjëzit të lidhurë
ngā një shpyrtërash përgjigje,
gjithasājtëna të shprishurë,
edhe mё se prej fuqīvet
kundrështare, çë, për bînda,
në të prēme të hapsirës
rrugë t' vetëshme i shtrëngojën,
me veprim të bashkrenduam,
që të sīllem rreth njī mesi,
të patundëshim ndaj tyre,
po çë sīllet rreth njī tjetri
me të gjithë ata t' bashkimit,
pā u përpjekur shoq me shoqin.
I të shumëvet, kūr tokës
i lё kurmin, më një herë

cause di corpi, oltrepassano,
e mestizia non conoscono, né vecchiezza
e si liberano per sempre
dalla rinascita e dalla morte;
poiché il loro spirito beato,
dopo la separazione, se ne va
in un astro migliore.
Né essi dimenticano in quelle regioni
l'antica terra, dove per prima
ebbero dimora e dove lasciarono
molti altri in travaglio
perenne ed aspro;
come non dimentica la paterna cosa,
dove crebbe come un bel fiore,
la ingenua sposa novella,
quantunque felice nella propria.
Perciò di là ne piovono raggi
di amore divino
e d'intelligenza immortale,
che in alto ci attraggono il cuore
e che ci sollevano la mente,
come la luna le onde del mare.
Tra loro così e con la terra
sono legati gli astri
da una corrispondenza di anime
da per tutto sparse,
ancor più che dalle forze
contrarie che, in modo mirabile,
per una stabilità dello spazio
via particolare li costringono,
con azione coordinata,
a girare attorno ad un centro,
immobile rispetto ad essi,
ma che a sua volta gira attorno ad un altro
con tutti quelli del suo sistema,
senza che uno urti contro un altro.
Dei più, quando alla terra
lascia il proprio corpo, d'improvviso

ndihet shpyrti i lehtësuar.
por i dhêmbur, për së parit,
ngā ajo ndārëje e si i trêmbur
për të rāt çë sheh, sā i duket
sc, ngā nj' êndërrë tue dalë,
atê herë i hapen sŷt
me t' vërtetë, e rrī i ndërdyshëm
e n' mejtim. I shkret, i vetëm,
si ndë shesh të thāt e t' gjêrë,
të pamasë e të tmerroshëm,
nën të rêndës kupë t' qiellit
shumë t' errêt e t' mërījtur,
i të kcqit ndodhet shpyrti
në drē t' madhe, si nji' zbjerrë
udhëtār çë ndien shtërgatën
e nuk dī ku t' gjenjë shtrehë.
Por ashtu nuk mbetet tepër
e trajtonjësin pushtet
heth për rreth e kap një
të papizëlë, tue bêrë
kurmi të rī, gjithnjê n' fytyrë
mc atê tjatërin çë ngjāllte,
e të shqisevet të gjitha
trapis veglet, ngjēr më t' pāmit.
Edhe qe se behas dredha
e rrëmben, si zok çë pendësh
s' u kā veshur, e për n' erës
e xarris, më kot n' ankime,
e këtu e këtje, pā u ndalur,
e përplas, e heth, e shtŷn
lart e posht, në zjarm e n' ujë,
e s' e lê të marnjë frŷmë,
as një t' imtë, e vëç kujtimit
çë po e brên e s' e faron,
pas dëshirit mê të nxeht
ç' atâ tjerët gjithë i shuan,
të të dashurit lirīn
krejt i heq e t' shtjerë n' punë

l'anima si sente alleviata,
ma dolente, in sulle prime,
di quella separazione e come impaurita
per le novità che vede, si che le sembra
che svegliandosi da un sogno
allora le si aprano gli occhi
veramente, e se ne sta dubbiosa
ed in pensieri. Abbandonata,
come in una vasta e sterile landa
immensa e spaventosa,
sotto la grave volta del cielo
assai fosco e minaccioso,
ritrovasi l'anima del malvagio
in gran terrore, come un perduto
viandante che sente la tempesta
e non sa dove trovar riposo.
Ma non dura a lungo in tale stato
e la potenza formatrice
irradia intorno e prende una materia
non molecolare, creandosi
un corpo nuovo, uguale nell'aspetto
all'altro, che essa già avvivava
e dei sensi tutti
abbozza gli organi, sino alla vista.
Ed ecco che di un subito il turbine
la afferra, come uccello che di piume
non si è vestito, e per l'aria
la trascina, indarno gemente,
e di qua e di là, di continuo
la sbatte, la scaglia, la spinge
di su e di giù, nel fuoco, nell'acqua,
e non le lascia prender fiato
nemmeno per un istante, e tranne la memoria
che la rode e non la distrugge,
secondo il desiderio più ardente
che ogni altro le spegne,
del volere la libertà
del tutto le toglie e di avvalersi

të veshtrimit t' tij të paktit
zotësīn i pret të têrë.
Kūr i vjen e t' gjymtyruarit
stina e thênë, ai, si i ndjekur,
për në leth të zī t' harresës
hidhet posht e, të shpëtonjë,
pā të zgledhur e pā māll,
zê në fembrë ngā mê t' ligat
çë, në t' nêmur vênt të huaj,
lojë t' poshtëra e jo shoqe
janë t' egrish të pazêmbrë,
te të cilët thuaj se mirë
s' u kā ndār ngā shtêza burri.
Ashtu hidhet her' e herë
drêri i gjuar në gorromimë,
kūr nuk sheh, prej frikës s' madhe,
rrugë tjatërë shëndeti.
Ndryshe shpyrti i atij njeriu
çë s' u ndot me faje i têrë
e çë t' Zotit pati besë
të pathyëeshme edhe të plotë
te i pasosmi përdëlim,
dhe çë s' humbi kūrr shëpresën
e shpërblimit, i përitur
isht te praku i s' dytës jetë
ngā disā ç' e deshën mirë,
do gjërī, do miq' e t' njohurë,
e do qênse mê të lertë,
çë me t' but edhe me t' êmbël
ngushëllim e ndihmë i japin
sā të bênjë t' madhin hap,
pas të çilit mêndi i çilet
e shkëlcen, si prush i gjallë
kūr i nxier një frŷmê hîrin
ç' e pështron. Më njê, prej vehtës,

γ 211 | — shkretit\ paktit| 218 | — grua\ fembrë| | — të\t' | 229| — \ i têrë | 233 | — \ çë s']

della scarsezza del suo intelletto
le paralizza affatto il potere.
Allorché le giunge del riprender membra
l'epoca stabilita, essa, come inseguita,
verso la negra palude dell'oblio
si butta giù e, pur di sfuggire,
senza scelta e senza amore,
s'incorpora in femmina tra le peggiori
che, in esecrando luogo straniero,
vile ludibrio e non compagne
sono di selvaggi crudeli,
nei quali quasi del tutto ancora
non si è separato l'uomo dalla bestia.
Così talvolta precipita
il cervo perseguitato giù da un burrone,
quando non vede, per il gran terrore,
altra via di salvezza.
In vece l'anima di colui
che non s'imbrattò totalmente di colpe
e che di Dio ebbe fede
inconcussa e piena
nell'infinita misericordia,
e che non perdette mai la speranza
della redenzione, attesa
è in sul limitare della seconda vita
da molti che già la amarono,
sia parenti, sia amici e conoscenti,
e sia entità superiori,
che benignamente e con dolcezza
conforto ed aiuto le prestano
a fare il gran passo,
dopo il quale la sua mente si apre
e rifulge, come brace viva
allorché un soffio portava la cenere
che la ricopre. Tosto, da se stesso

posa veshi t' lehtën mlojë,
zê fill veprën e thjellimit,
tuke u sjellë atje ku i duhet
për të mirë edhe për gjyq,
e kā bashk fatbardhë shokë
edhe sheh se fēja e mbarë
êsht të dhênë n' dorë t' Zotit,
dashurī e të përkushtuam,
flîja e vehtes e të lutur
edhe punë pā qëlluame
e pā qyrë të vecantë,
po të gjithëve e t'atdheut
për shëndet. Kështu i shëndoshur
i qëruam edhe i kulluam,
njeh se ç' ishte e se kush ishte
për së parit, e mbi tokën
kush u duk ai, ngā herë
çë zû shtāt, edhe pas fatit,
pas të lidhurit ngā t' bêmat
të përparëshme në jetë,
pas të dridhurit, ç' e telq
për qërtim e për të vjeftur,
zgleth ndër njerëzit ndë vonë
ata prindëra, ç' i duken
mê të mirë, e shkon pameta
ndëpër leth të zī t' harresës
e si i rī pameta lēhet,
ndonse t' shkuamit për atê
s' dolli t' kot, pas ligjës s' madhe
të t' parēmit përparim
çë gjithqishten kā nën urdhër.

γ 258 | —\ shëndoshur|

dopo d'essersi rivestita del tenue involucro,
inizia l'opera della purificazione,
recandosi là ove le conviene
per il suo meglio e per giustizia,
ed ha dei compagni avventurati,
e che vede come la vera religione
non sia che piena confidenza in Dio,
amore e devozione,
sacrificio di sé e preghiera
ed azione senza fini
e senza attesa personali,
ma di tutti e della patria
per la salute. Così risanata
e mondata e purificata,
conosce quel che era e chi era
in sul principio, ed in terra
chi essa parve, ogni volta
che prese corpo, e giusta il fato,
secondo il legame delle azioni
compiute nella vita precedente,
secondo la necessità, che la attira
per emenda e per vantaggio,
sceglie fra gli uomini finalmente
quei genitori, che le sembrano
più adatti, ed attraversa di nuovo
la bruna palude dell'oblio,
e come un nuovo essere rinasce,
quantunque per lei il passato
non sia per nulla inutile, giusta la gran legge
dell'infinito progresso
che domina l'universo.

Indice

VIII.– Il *Këthimi* p. V
§ 1.– *Premessa* V
§ 2.– *Il* Këthimi: *i manoscritti* VII
§ 3.– *L'edizione del 1965 del* Këthimi *e criteri dell'edizione critica* XVIII

IX.– Il *Mino*, le opere teatrali, *Mantnēr* XXV
§ 1.– *Premessa* XXV
§ 2.– *Il* Mino XXVI
§ 3.– *Le opere teatrali:* Nerone e Messalina XXVII
§ 4.– *L'ultima incarnazione di Mantnēr* XXX

Testi

Këthimi 3

Mino 279

Opere teatrali 345
Nerone 347
Messalina 361

L'ultima incarnazione di Mantnēr 391

Finito di stampare nel mese di luglio 1998
dalla Rubbettino Arti Grafiche
per conto della Rubbettino Editore Srl
88049 Soveria Mannelli (Catanzaro)

ISBN 88-7284-608-0